

NATURAL  
POOL&SPA



@NATURAL POOL&SPA



WWW.NATURAL-KS.COM



+38348473473



SOJEVË, FERIZAJ

TRAVEL MAGAZINE

TETOR - NËNTOR 2025

# GP MAGAZINE

AIRPLANE MAGAZINE

*Edon*  
**ZHEGROVA**  
"MESSI I KOSOVËS"

**VJESHTA**  
e festivaleve të  
këngëve në Kosovë

**NË GP  
AVIATION**  
jetësohet ëndrra e  
pilotëve shqiptarë

**FAZILE BUNGU**  
një jetë përkushtuar  
përtej vetes

**GJIROKASTRA,**  
qyteti i gurtë që ju lë  
kujtime të paharruara

## PËRSHTYPJET E.. DUALIPËS PËR VIZITËN NË "REPORTING HOUSE"



POLIKLINIKA SHOSHI

**SKANO DHE PËRFITO  
10% ZBRITJE NË TË GJITHA  
SHËRBIMET TONA!**



Prishtinë +383 48 124 298 - Istog +383 45 292 112 - Deçan +383 45 866 666



# GOGAJ

ÇDO GJË PËR SHTËPINË TUAJ!

LEXO ARTIKULLIN NE FAQE: 31

**"FUQIZOJMË  
MARKËN TUAJ**

**SJELLIM REZULTATE  
TË VËRTETA."**



POSSIBILITIES & PARTNERS

→ CONTACT US

www.pfp-ks.com

# ELEGANCË PËR TY



Kërkesat për banim dhe renovim tashmë janë në maksimum, zyrë, shtëpi, banesë apo dyqan. Gjatë kohës së qëndrimit brenda, anëtarët e shtëpisë do ta ndajnë hapësirën për një kohë të gjatë.



Në një shoqëri ku krijimtaria është rritur, hapësirat tona duhet të jenë frymëzuese duke reflektuar individualitetin, vlerat dhe përvojat tona.



Përveç funksionalitetit, shtëpia duhet të jetë gjithashtu emocionuese, një vend luksoz dhe qetësues.

Një gamë të gjerë dritaresh të projektuara me saktësi që mund të plotësojnë edhe kërkesat më të larta për stil, performancë dhe inovacion. Të krijuara sipas masës me profile elegante, sipërfaqe të mëdha xhami që lejojnë dritën të vërshojë, ndërsa izolimi superior siguron rehati, efikasitet energjie dhe kursime në kosto.



Timber Home ndihmon konsumatorët të krijojnë hapësira unike dhe ekspresive përmes modeleve të shumta të dyerve, dritareve dhe kuzhinave.



+383 (0) 48 398 398



[www.timber-ks.com](http://www.timber-ks.com)



[timberhomeks@gmail.com](mailto:timberhomeks@gmail.com)

# ZGJEDHJA JONË PËR VJESHTËN

Të dashur lexues të GP Magazinë,

**N**ë numrin e ri, ju sjellim më shumë risi, përmbajtje të veçanta dhe rubrika të dedikuara posaçërisht për ju. Ky edicion është menduar si një udhërrëfyes i këndshëm për ditët e vjeshtës dhe verës që na presin – me shije, kulturë, histori dhe frymëzim.

Në këtë sezon, do të ndalemi tek ushqimet tradicionale dhe industria që po lulëzon në Kosovë mbi bazën e trashëgimisë së gatimit. Do të njiheni me receta autentike, produkte artizanale dhe histori që i japin shpirt tryezës sonë.

Për adhuruesit e historisë, kemi përgatitur rrëfime për të kaluarën dhe udhëtime në zonat historike që presin të zbulohen. Do të vizitojmë qytete të bukura si Gjirokastra, Vlora, Prishtina, Ferizaj dhe shumë destinacione të tjera, ku mikpritja, traditat dhe kuzhina lokale janë gjithmonë pjesë e eksperiencës.

Në këtë numër, vend të veçantë zënë edhe njerëzit që bëjnë ndryshimin - humanistë, aktivistë të komunitetit dhe figura që frymëzojnë shoqërinë tonë. Nuk do të mungojnë as sukseset sportive, si ai i Edon Zhegrovës, të cilin e shënojmë me krenari në faqet tona.

Po ashtu, kemi përzgjedhur për ju zhvillime nga e gjithë bota - në turizëm, kulturë, teknologji dhe tendencat globale që formësojnë jetën tonë të përditshme.

Për fëmijët, kemi përgatitur dy rubrika të veçanta: "Këshillat nga mësuesi", për të mbajtur të lidhur sidomos fëmijët e diasporës me gjuhën dhe kulturën, si dhe "Përrallat e bukura në shqip", që u flasin më të vegjëlve me gjuhën e zemrës.

Si gjithmonë, bashkëpunimi ynë me mjekë, mësues dhe profesionistë të fushave të ndryshme na mundëson t'ju ofrojmë përmbajtje të besueshme dhe me vlerë praktike për jetën tuaj të përditshme.

GP Magazinë mbetet pranë jush – udhëtarëve, investitorëve, familjarëve dhe të gjithë atyre që duan të jetojnë me përmbajtje dhe frymëzim.

Ju urojmë pushime të mbara dhe udhëtime të sigurta kudo që të jeni!



**Adresa:** Prishtinë, Mati 1. nr.31  
**Tel:** +383 44 326 143  
**E-mail:** [service@gp-aviation.net](mailto:service@gp-aviation.net)  
[marketing@gpmagazine.info](mailto:marketing@gpmagazine.info)  
**Tel:** +383 49 49 94 95





POLIKLINIKA SHOSHI

**MBI 35 VITE PËRVOJË NË SHËRBIMIN  
E SHËNDETIT TUAJ.**

Poliklinika Shoshi - Prishtinë +383 48 124 298  
Poliklinika Shoshi & Optika Ylli - Istog +383 45 292 112  
Optika Shoshi - Deçan +383 45 866 666

@poliklinikashoshi.optikaylli  
poliklinikashoshi.com



**Molla Egër**  
AGROTURIZËM



## E GJITHA NËN OMBRELLËN E NATYRËS

Shije Autentike nga  
Zemra e Natyrës

Zbuloni një përvojë  
unike agroturizmi në  
Molla Egër, ku tradita  
takohet me freskinë e  
natyrës.

Ushqime tradicionale  
shqiptare, mish i terun,  
ramstek i terun,  
suxhuk, mish rose,  
mish qure, pule fshati  
nga ferma jonë, fli, pite,  
krelane, djathra të  
ndryshme, kos, mazë,  
tlyn, speca dhe domate  
turshi, ajvar, pestil, –  
gjithçka e përgatitur  
me dashni dhe  
përkushtim.

Vizitoni fermën dhe  
bahçen tonë,  
relaksohuni në parkun  
për vizitor dhe kaloni  
momente të veçanta  
me familjen.

Molla Egër – gjithçka  
tradicionale dhe bio.





## VENDI I FAMILJES, SHOPPINGUT, ARGËTIMIT DHE KINEMASË MË SPEKTAKOLARE NË KOSOVË

Vetëm 2.8 kilometra larg qendrës së Prishtinës, në një lokacion të aksesueshëm nga çdo drejtim dhe me mbi 40,000 makina që kalojnë çdo ditë pranë tij, **Albi Mall** është më shumë sesa një qendër tregtare – është një botë e tërë për të eksploruar.

Me mbi **250 brende ndërkombëtare** që sjellin trendet më të fundit në modë, **Albi Mall** është destinacioni ku stili takohet me cilësinë. Prej Zara, Massimo Dutti, Zara Home, XYZ, Guess, Hugo, Replay, Armani Exchange, Boss, Mango, Parfois, Okaidi, Carpisa, Stilium e deri te Antony Morato, dhe shumë të tjera – këtu gjeni gjithçka që keni ëndërruar për garderobën tuaj.

Por **Albi Mall** nuk është vetëm modë. Është edhe shije, ritëm dhe emocione. Për një pauzë perfekte, zgjidh mes dhjetëra restoranteve dhe kafeneve moderne, nga kuzhina lokale te ajo ndërkombëtare.




Me mbi 10 milionë vizitorë në vit,  
**Albi Mall** është më shumë se një qendër  
tregtare – *është vendi i familjes suaj.*

Dhe për ata që kërkojnë përjetime unike? **Cineplexx** tani ka sjellë për herë të parë në Kosovë teknologjinë mahnitëse të **IMAX** – ekrani më i madh, zëri më i fuqishëm dhe përjetimi më intensiv kinematografik që keni provuar ndonjëherë. Filmat nuk shikohen më, ata përjetoohen!

Për të vegjlit, **Albi Mall** është vendi i ëndrrave: kënd lojërash, aktivitete të pafundme dhe atmosferë që frymëzon imagjinatën. E për ata më aktivët – bowling, karaoke dhe ngjarje të përjavshme që sjellin çdo herë diçka të re.

CURRENTLY OPERATING  
IN  26 LOCATIONS  
AND 3 COUNTRIES

SINCE 2009 - ONLY THE BEST INGREDIENTS - 



# SACHPIZZA®

[www.sachpizza.com](http://www.sachpizza.com)

SACHPIZZA

# 1

FIRST AND  
THE LARGEST

WOOD FIRED PIZZA  
CHAIN IN THE REGION

## SACHPIZZA



  
**SACH  
PIZZA**

## KUSH JEMI NE?

Dardania Model është një fabrikë që prodhon dyer dhe dritare nga materiale si PVC, alumin, dru-alumin, si dhe mobilie përmes një departamenti të veçantë. Kompania vepron që nga viti 1958 dhe produktet e saj përmbushin standardet ndërkombëtare për efikasitet termik, performancë, dizajn, cilësi, dhe qëndrueshmëri.



### Dyer

Dyert tona prej druri kombinojnë elegancën, sigurinë dhe qëndrueshmërinë, të personalizueshme sipas stilit dhe nevojave tuaja. Në Dardania Model, krijojmë dyer që përmirësojnë çdo hapësirë të shtëpisë tuaj.



### Dritare

Dritare prej druri, alumini, PVC, me materiale cilësore sjellin stil, qëndrueshmëri dhe efikasitet energjie, të personalizueshme sipas nevojave tuaja. Në Dardania Model, përmirësojmë çdo hapësirë me dizajn dhe funksionalitet.



**Edon Zhegrova ka lindur më 31 mars të vitit 1999 në Herford të Gjermanisë, nga prindër shqiptarë, të cilët ishin shpërngulur nga Kosova gjatë luftës së fundit. Kur Edoni ishte vetëm dy vjeç, familja e tij u rikthye në Kosovë dhe u vendos në Prishtinë.**

**P**asioni i tij për futbollin ishte i dukshëm që në fëmijëri. Karrierën e nisi në klubin Flamurtari, ndërsa më vonë kaloi te Prishtina, ku shpejt filloi të tërhiqte vëmendjen me paraqitje mbresëlënëse dhe gola të shumtë.

Në vitin 2012, gjatë një kampi trajnimi, të organizuar nga gjiganti italian AC Milan në Kosovë, Zhegrova u dallua për talentin e tij dhe ishte mes lojtarëve të përzgjedhur për të vizituar stadiumin legjendar “San Siro”, duke zhvilluar edhe disa seanca stërvitore në Itali.

**N**ë moshën 15-vjeçare, Edoni nisi karrierën ndërkombëtare, duke u bashkuar me ekipet e të

rinjve të Standard Liège dhe Sint-Truiden në Belgjikë.

**D**ebutimi i tij si profesionist erdhi në vitin 2017 me klubin belg Genk, ku për herë të parë tregoi potencialin në një ligë të madhe.

Pas Belgjikës, karriera e tij vazhdoi në Zvicër, te FC Basel, ku për dy sezone bëri paraqitje shumë të mira, duke u kthyer në një nga lojtarët më të spikatur të Superligës zvicerane. Në vitin 2022, Zhegrova u transferua në Lille OSC në Francë, për 7 milionë euro, klub me të cilin zhvilloi tre sezone të suksesshme, duke shënuar disa gola të rëndësishëm dhe duke ndihmuar ekipin në garat evropiane.

**FMO**  
**Prishtinë**  
disa herë në javë



**FLUGHAFEN**  
**MÜNSTER**  
**OSNABRÜCK**



## STATISTIKAT DHE VLERA NË TREG

Ndeshje me klube  
**(Genk, Basel, Lille):**  
MBI 200 NDESHJE  
**Gola të shënuar me klube: 40 gola**  
PARAQITJE ME  
KOSOVËN:  
**42 ndeshje**  
GOLA ME KOSOVËN:  
**5 gola**  
VLERA NË TREG  
(2025): **Rreth 25 milionë euro.**

## TRANSFERIMI TE JUVENTUSI

Në shtator të këtij viti (2025), pas ofertave nga disa klube të njohura evropiane, Zhegrova zgjodhi të bashkohet me klubin legjendar italian, Juventus, duke nënshkruar kontratë deri në vitin 2030. Për Zhegrovën Juventus i pagoi rreth 20 milionë euro duke e bërë njërin ndër futbollistët me të shtrenjtë shqiptarë të transferuar në Serie A. Debutimin me “Zonjën e Vjetër” e bëri në Ligën e Kampionëve kundër Borussia Dortmund, ku për minutat e luajtura dha sinjale të forta se do të jetë një përforcim i rëndësishëm për skuadrën.

## KARRIERA ME KOMBËTAREN E KOSOVËS

E don Zhegrova priti me padurim ftesën nga Kombëtarja e Kosovës, edhe pse kishte mundësi të përfaqësonte Shqipërinë. Debutoi për Kosovën në vitin 2018 dhe që në ndeshjen e parë shënoi gol, duke u bërë lojtari më i ri që kishte shënuar ndonjëherë për përfaqësuesen në atë kohë.

Së bashku me Amir Rrahmanin, Vedat Muriqin dhe Milot Rashicën, Zhegrova është pjesë e “bërthamës së artë” të Kosovës. Me stilin e tij të lojës, të bazuar në driblim, kreativitet dhe gola spektakolarë, shpesh është quajtur me të drejtë nga tifozët dhe analistët si “Messi i Kosovës”.

## NJË SIMBOL PËR BREZIN E RI

E don Zhegrova është jo vetëm një futbollist i talentuar, por edhe një simbol shprese për gjeneratat e reja të Kosovës. Me lojën e tij plot fantazi,

ai ka sjell emocione të veçanta për tifozët dhe ka treguar se edhe Kosova mund të nxjerrë futbollistë të nivelit botëror.







**BÄCKEREI**  **KONDITIONEIREI**

**BERG AM LAIM**  
**BAUMKIRCHNER STR.12**  
**TEL:+491623962484**





# SHIJE E VËRTETË SHQIPTARE!

Mirësevini në furrat tona në München, aty ku tradita dhe shija bashkohen në çdo produkt! Nga buka e sapopjekur me brumë të punuar me dorë, deri te hyrëkët krokantë e emhëlsirat tradicionale, ne sjellim aromën dhe shijen e kuzhinës shqiptare në tryezën tuaj. Ejani të shijoni recetat e trashëguara brez pas brezi, të përgatitura me përbërës natyralë dhe dashuri!



**TRADITË,  
SHIJE  
DHE CILËSI**



**FOSTENRIEDER-ALLE**  
**WINTETTHURER STR.2**  
**TEL: +4915510382613**







# Optika Moda

## Gjithçka për sytë e ballit



Optika Moda është lider në industrinë e optikës në Kosovë dhe një nga më të njohurat në rajon. Kjo optikë komunikon një histori të tërë që nga dita e parë e daljes në treg në vitin 2010. Ajo që nisi si një ëndërr u bë një histori në botën e optikës.

Sot Optika Moda me një rrjet të gjerë në mbarë Kosovën ndjek trendet më të fundit teknologjike dhe ofron shërbime moderne.

Optika Moda ofron kontrollë dhe përcaktim të dioptrisë me metoda dixhitale nga okulistë dhe ekspertë të optometrisë.

Optika Moda   
optikamoda 

049 114 090  
[www.optikamoda.com](http://www.optikamoda.com)





# BIZNESI ME PETULLAT E **FLISË**

Gentiana Ahmeti

## **Flija - tradita që u bë biznes**

Nëse ndonjëherë e keni vizituar Kosovën, është e pamundur të mos keni dëgjuar për flinë. Kjo kryevepër e kuzhinës tradicionale, e përgatitur me shtresa të holla brumi të pjekura një nga një nën saç, është më shumë se një ushqim. Është kujtim i gjallë, është rit i vjetër, është shenjë mikpritjeje.

Dikur, në oborret e shtëpive, gratë kalonin orë të tëra pranë zjarrit, duke hedhur shtresë pas shtrese, derisa tava e madhe mbushej me aromën që mblidhte familjen rreth sofrës. Sot, kjo traditë po merr jetë të re: është kthyer në biznes dhe po i jep një dimension tjetër gatimit shekullor.

## **Nga oborri i shtëpisë, në zemër të Prishtinës**

Një nga shembujt më të bukur të këtij transformimi është historia e Zahide Bahtiri Fetahut. Prej më shumë se dhjetë vjetësh, ajo e ka kthyer flinë në profesion. Në Prishtinë, lokali i saj është bërë destinacion i rregullt për klientë që kërkojnë shijen autentike të traditës.

“Fillimisht ishte ide e marrë nga gjyshet e nënat tona. E nisëm për qejf, për familjarët, por shpejt e pamë që kërkesa ishte shumë më e madhe. Kështu vendosëm ta shndërrojmë në biznes”, tregon Zahidja.

Sot ajo e menaxhon këtë punë bashkë me familjarët, ndërsa gjatë verës, kur mërgimtarët

kthehen në atdhe, punëson deri në katër persona shtesë. Ramazani dhe festat gjithashtu sjellin një fluks të madh porosish, duke e bërë këtë periudhë një maratonë pune.

## Një ditë me flinë

Ora 6:00 e mëngjesit e gjen Zahiden pranë tri furrave të drurit, duke i përgatitur për një ditë të gjatë. Procesi i gatimit është i ngadalshëm, kërkon durim e përkushtim: çdo shtresë piqet me kujdes dhe radhitet me dorë. Shpesh, dita i mbaron pas orës 22:00, me dhjetëra fli të dorëzuara te klientët.

“Është biznes fitimprurës, por

shumë i lodhshëm. Çdo nënë apo motër që ka provuar ta bëjë e di sa e vështirë është të rrish pranë furrës së druve. Por puna ime bëhet më e lehtë kur e shoh kënaqësinë e klientëve që e shijojnë flinë time”, thotë ajo me buzëqeshje.

Një fli e plotë kërkon të paktën dy orë punë intensive, ndërsa në madhësi të mëdha procesi mund të zgjasë katër deri në pesë orë. Në treg, çmimi varion nga 15 deri në 50 euro, në varësi të madhësisë dhe kërkesave të klientëve.

## Shije që lidh gjenerata

Flija nuk është vetëm ushqim. Ajo është urë mes brezave, kujtesë

e sofrave të dikurshme dhe dëshmi se si tradita mund të përshtatet në kohë moderne.

Zahidja ka vendosur ta ruajë recetën autentike: vetëm dru, saç dhe durim. Çdo fli që del nga duart e saj bart një aromë që të çon pas në kohë, në oborret e fëmijërisë.

Por kjo histori nuk është vetëm e saj. Për shumë gra në Kosovë, flija po bëhet një mundësi e re ekonomike – një mënyrë për të ndërtuar të ardhmen mbi një trashëgimi të vjetër. Dhe, kështu, ky ushqim tradicional jo vetëm që po mbijeton, por po lulëzon në tregun modern.



# GREMJA - “KINA E VOGËL” E MOBILIEVE NË KOSOVË

Gentiana Ahmeti

Vetëm pesë kilometra në jug të Ferizajt ndodhet një fshat i vogël, por me ndikim të madh ekonomik: Gremja. I njohur ndryshe si “Kina e vogël” e mobilieeve, ky vend është shndërruar në një qendër prodhimi me ndikim të rëndësishëm për tregun vendor dhe eksportues.

## Një industri që lindi nga zanati

Pas viteve '90, kur fabrika e dikurshme “Tefik Çanga” pushoi aktivitetin, dhjetëra punëtorë e sollën zanatin e mësuar në oborret dhe shtëpitë e tyre. Nga këto fillime modeste, Gremja sot ka rreth 100 punishte dhe fabrika mobilieeve,

nga bizneset familjare deri te prodhuesit e mëdhenj.

Në këtë sektor janë të punësuar rreth 1.500 persona, duke e bërë industrinë e mobilieeve një prej gjeneratorëve kryesorë të punësimit në rajon. Përveç mobilieeve, fshati ka zhvilluar edhe aktivitete ndihmëse – prodhim dyersh dhe dritaresh plastike, punime xhami dhe shërbime tregtare, duke e konsoliduar profilin e tij si një qendër të plotë ekonomike.

## Shoqata, si motor bashkëpunimi

Për të përballuar konkurrencën dhe për të avancuar cilësinë, para gjashtë vjetësh bizneset vendore themeluan Shoqatën e përpunuesve të drurit në Greme.

“Konkurrenca është e ashpër, por të shtyn të punosh më mirë





dhe të rritësh kualitetin”, thotë Gazmend Murseli, kryetar i Shoqatës dhe pronar i mobilierisë “Rinia”.

## Nga tregu vendor, tek eksporti evropian

Rruga e zhvillimit nuk ka qenë e lehtë. Shumë biznese nisën si punishte të vogla dhe gradualisht u zgjeruan.

Gazmend Ahmeti, pronar i mobilierisë “Sharri”, tregon:

“Pas luftës i kemi ndjekur kryesisht tregjet në Kosovë,

ndërsa nga viti 2008 kemi filluar eksportin, fillimisht në Zvicër dhe më pas në vende të tjera të Evropës.”

Sot, mobiliat e Gremes shiten jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj, duke ndjekur kërkesën e diasporës kosovare dhe tregjeve evropiane.

## Një model ekonomik lokal

Sipas administratorit të fshatit, Besim Ahmeti, Gremja është bërë një model për zhvillimin ekonomik të Kosovës:

“Çdo ditë kemi vizitorë nga qytete të ndryshme që furnizohen me mobilie nga Gremja. Ky fshat prin për prodhim, por qëndron shumë mirë edhe në sektorë të tjerë.”

## Një markë e njohur përtej kufijve

Sot, Gremja nuk është vetëm një fshat prodhues, por një markë ekonomike që lidhet me cilësi dhe mjeshtëri. Çdo kuzhinë, dhomë gjumi apo divan i prodhuar aty, është dëshmi e një tradite të punës që ka kaluar brez pas brezi.

Ndaj, epiteti “Kina e vogël” nuk është thjesht metaforë: është përshkrim i një realiteti ku një fshat i vogël është kthyer në qendër prodhimi, eksporti dhe inovacioni në industrinë e mobilieve të Kosovës.



# "Fuqizojmë markën tuaj. Sjellim rezultate të vërteta."

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur,  
PFP – Possibilities for Partners është partneri juaj  
strategjik për rritje, vizibilitet dhe ndikim.

Na Kontaktoni Këtu!

☎ +383 43 899 331

🌐 [www.pfp-ks.com](http://www.pfp-ks.com) ✉ [info.pfp.ks@gmail.com](mailto:info.pfp.ks@gmail.com)

📍 Prishtinë, Rexhep Luci, Pristina, Kosovo



## Marketing & Strategji

Fushata të personalizuara që arrijnë  
audiencën tuaj ideale.



## Marketing Dixhital

Menaxhim i rrjeteve sociale, Google Ads,  
Email Marketing dhe më shumë.



## Public Relations

Ndërtim dhe ruajtje e një imazhi pozitiv  
për markën tuaj.



## Produksion Multimedial

Video profesionale, grafika kreative,  
përmbajtje audio dhe vizuale për çdo  
platformë.



## Web Design & Development

Websites të dizajnuar me kujdes,  
funksionalë dhe të optimizuar.



## Zgjidhje IT

Sisteme të personalizuara që rrisin  
efikasitetin dhe automatizimin.

*Që nga marketingu klasik dhe dixhital, e deri-te prodhimi kreativ, ndërtimi i faqeve të internetit dhe zgjidhjet  
inteligjente IT, ne ofrojmë zgjidhje të personalizuara për çdo biznes që synon të dallohet dhe të rritet.*

# NATURAL POOL & SPA



- 1 Pishinë e brendshme për të rritur Premium
- 1 Pishinë e brendshme për të rritur me qasje direkte në pishinën e jashtme ( e përshtatshme për cdo stinë )
- 1 Pishinë për fëmijë

- 1 Indoor swimming pool for adults Premium
- 1 Indoor swimming pool for adults with direct access into the outdoor swimming pool (available at any season)
- 1 Swimming pool for children



- 4 Sauna të jashtme finlandeze
- 4 Sauna të brendshme finlandeze
- 1 Saun e brendshme me rreze infra të kuqe
- 1 Saun e brendshme bimore

- 4 Outdoor Finnish saunas
- 4 Indoor Finnish Saunas
- 1 Indoor Infrared Sauna
- 1 Indoor Herbal Sauna




- 5 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ngrohtë
- 3 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ftohtë
- 3 Jacuzzi të brendshëm

- 5 Outdoor Jacuzzis with warm water
- 3 Outdoor Jacuzzis with cold water
- 3 Indoor Jacuzzis



- 1 Hammam (Banjë Turke) | 1 Hammam (Turkish Bath)



- 2 Solarium për rrezitje | 2 Tanning Bed Solarium



- Masazh | Massage

## RRETH NESH / ABOUT US

Natural Pool & SPA është një vend perfekt që ofron një përvojë unike për ata që kërkojnë qetësi dhe relaks! /

Natural Pool & SPA Is a perfect place that offers a unique experience for those looking peace and relaxation!

+383 48 473 473  
WWW.NATURAL-KS.COM

@NaturalPool&Spa



# FAZILE BUNGU - NJË JETË PËRKUSHTUAR PËRTEJ VETES

Në Ferizaj, mes rrugëve të zhurmshme të qytetit, jeton një grua e qetë, por me një histori që tingëllon si udhërrëfyese e humanizmit. Quhet Fazile Bingu, gruaja që sot njihet si themeluese e shoqatës HENDIFER dhe si shpresë për qindra persona me aftësi të kufizuara.

## Nga dhimbja personale, te misioni shoqëror

Gjithçka nisi në vitin 1979.

Një aksident i rëndë me tren ia dëmtoi këmbën, duke ia ndryshuar përgjithmonë jetën. Por, Fazilja

nuk e pa këtë si fund. Dhimbjen e shndërroi në forcë dhe nisi të ndihmojë të tjerët.

“

**Të jesh person me aftësi të kufizuara në Kosovë ishte si të ishe në një burg të izoluar”, rrëfen ajo, duke kujtuar fillimet.**

Në vitet '90, kur presidenti Ibrahim Rugova kërkoi të bëhej evidentimi i personave me aftësi

të kufizuara, Fazile Bingu ishte ndër të parat që doli në terren. Aty kuptoi realitetin e hidhur: mijëra persona jetonin të mbyllur brenda katër mureve, të harruar nga shoqëria. “E kam pa se në çfarë mjerimi jetojnë dhe prej asaj dite kam nisë punën. Tani punoj dhe kurrë s'do të ndalem sa të kem shëndet”, thotë ajo.

## 32 vjet vullnet, pa pagë

Prej më shumë se tre dekadash, Fazile Bingu punon pa marrë asnjëherë pagë. “Punoj për shpirtin tim”, thotë ajo me bindje, duke treguar se financat personale ia

mbulon djali i saj nga diaspora. Edhe kur shoqata fiton projekte, në listën e pagave ajo e vendos vetëm stafin, jo veten.

### **HENDIFER – një strehë për qindra njerëz**

Në vitin 2002 ajo themeloi HENDIFER-in, shoqatën që sot u shërben mbi 170 personave çdo javë. Brenda saj, jeta rreh ndryshe: logopedë që ndihmojnë fëmijët në të folur, tri psikologe që ofrojnë terapi, një edukatore dhe një profesor arti që mban terapi grupe.



**Por puna nuk mbaron aty. Vullnetarët, kryesisht nxënës të shkollës së mesme të mjekësisë dhe gjimnazit, shkojnë në shtëpitë e atyre që jetojnë vetëm: pastrojnë, përgatisin ushqim, paguajnë faturat, kujdesen për shëndetin e tyre. Sot shoqata ka rreth 25 vullnetarë aktivë – dëshmi se solidariteti vazhdon të jetojë.**

#### **Një familje e rritur në mision**

Fazile Bungu nuk ka qenë kurrë vetëm. Familja e saj ka qenë gjithmonë pranë. Djali i saj, në një rast, i tha: “Nanë, jam i gatshëm



FOTO HENDIFER (FAZILE BUNGU)

edhe me nda krevatin me një fëmijë pa përkujdesje”. Vajza, që është rritur mes këtij misioni, sot punon me të, duke koordinuar punët e shoqatës.

#### **Një jetë që frymëzon**

“Ka vështirësi të shumta, sepse aty ku punohet, ka edhe sfida. Por unë nuk ndalem kurrë, për sa kohë kam shëndet”, thotë Fazilja.

Sot, në komunën e Ferizajt janë evidentuar mbi 5700 persona me

aftësi të kufizuara, të të gjitha moshave dhe diagnozave. Për secilin prej tyre, shoqata dhe puna e Faziles janë një dritë e vogël shprese.

Nëse ndonjëherë fluturoni mbi Kosovë dhe e shihni qytetin e Ferizajt nga dritarja e avionit, kujtoni këtë histori: në një ndërtesë modeste, një grua me një zemër të madhe ndez çdo ditë dritë në jetën e qindra njerëzve.



20

YEARS TOGETHER



Vitamina • Minerale • Hekur • Proteina

**LIRI®**  
Since 1985



# Sempre

**Rritemi së bashku me minerale dhe vitamina.**

Biskotat Sempre janë të prodhuara nga përbërës të ushqyeshëm, duke i siguruar fëmijës tuaj vitamina dhe minerale thelbësore.

Duke kafshuar dhe përtypur biskotat Sempre, më të vegjlit tuaj stimulojnë mishin e dhëmbëve dhe lehtësojnë daljen e dhëmbëve të parë.



Një porcion (100g) SEMPRE biskota përmban:

| Energji  | Proteina | Sheqer     | Yndyrna | Natrium  |
|----------|----------|------------|---------|----------|
| 343 kcal | 9.0 gram | 24.13 gram | 10 gram | 0.3 gram |
| 18%      |          |            |         |          |

Vlera mesatare e rekomanduar për fëmi në bazë ditore për konsumim prej 1800 kcal





# POTSDAM - QYTETI I PALLATEVE DHE KULTURËS PRANË BERLINIT

**N**ë rrugëtimin drejt Gjermanisë, vizitorët duhet me domosdo të rezervojnë një kohë për t'u ndalur në qytetin Potsdam. I ndërtuar pak kilometra afër Berlinit, Potsdam është një qytet me histori të pasur, arkitekturë mbresëlënëse dhe peizazhe të mrekullueshme.

Kryeqyteti i landit të Brandenburgut njihet veçanërisht për pallatet madhështore, kopshtet mbretërore dhe rolin e tij të rëndësishëm historik në Evropë. Pallati posedon një hapësirë gjigande me shumë vepra arti dhe është një nga pallatet më të bukura në Evropë.

Potsdam u bë i famshëm në shekujt XVII–XIX, kur shërbeu si rezidencë e mbretërve prusianë dhe më pas e perandorëve gjermanë. Trashëgimia më e njohur e kësaj periudhe është Pallati Sanssouci, shpesh i krahasuar me Versajën franceze. Ky pallat, i shekullit XVIII, ndërtuar për mbretin Frederik i Madh, është rrethuar nga kopshtet barokë që sot janë një destinacion i preferuar për turistët.

Potsdam ofron shumë më tepër se Sanssouci. Pallati i Reja (Neues Palais), Cecilienhof – ku u mbajt Konferenca e Potsdamit, në vitin 1945, dhe Pallati

Babelsberg janë vetëm disa nga monumentet që e bëjnë qytetin unik. Gjithashtu, Potsdam është i njohur për lagjen holandeze (Holländisches Viertel), një kompleks i veçantë me arkitekturë holandeze që e dallon nga çdo qytet tjetër gjerman.

## Qyteti i filmit

Potsdam është, gjithashtu, një qendër e rëndësishme e kinematografisë gjermane. Studioja Babelsberg është një nga studiot më të vjetra të filmit në botë, ku janë xhiruar filma të famshëm ndërkombëtarë.

I vendosur buzë lumit Havel dhe i rrethuar nga liqene dhe parqe, Potsdam është një destinacion ideal për dashamirësit e natyrës. Shëtitjet me biçikletë, lundrimet me varkë dhe ecjet nëpër kopshtet mbretërore, janë mënyra të shkëlqyera për ta përjetuar qytetin.

Falë afërsisë së tij me Berlinin (vetëm rreth 30 minuta me tren), Potsdam është një destinacion i përsosur për një udhëtim njëditor ose një qëndrim më të gjatë. Ai përmbledh historinë mbretërore, kulturën evropiane dhe bukuritë natyrore në një vend të vetëm.

# *vipa*



## **SHIJE TË PAREZISTUESHME**

*Vipa Chips gjithmonë pranë jush!*





# NDËRTIME CILËSORE!

Komplekse me lokacion ideal dhe hapësira  
të mjaftueshme për çdo stil të jetesës!

 **Arbëri, Prishtinë**



**KAMELEONI**  
SISTEME ALUMINI

*“Ndreqe terasen ftofja kojshisë”*



+383 49 800 020  
[www.kameleoni.biz](http://www.kameleoni.biz)  
[info@kameleoni.biz](mailto:info@kameleoni.biz)

📍 Kameleoni SHPK 📱 [kameleoni.llc](https://www.instagram.com/kameleoni.llc)

Rruga e pejës nr 460, Miradi e epërme 12000 Fushë Kosovë



# KOHA E LIRË E NXËNËSIT SHQIPTAR NË DIASPORË, EDUKIMI IDENTITAR DHE ROLI I PRINDIT

**Shkruan: Nuhi Gashi**

## 1. SHKOLLA, LOJA, KOHA E LIRË

Sado që koha që një nxënës i shkollës moderne e kalon në objektin shkollor ose në veprimtari që i referohen mësimi të rregullt dhe në njëfarë mënyre, për të qenë sa më e pranueshme dhe joshëse për nxënësin, duhet t'i ngjajë një 'lojë', përsëri pjesa tjetër e mbetur e ditës vërtetë duhet të mbushet me veprimtari të tjera të cilat, duke qenë më të lira nga të qenit e tyre të detyrueshme, identifikohen më për së afërmi me lojën dhe përveç funksioneve të shumta sjellin edhe kënaqësi. Ndërkaq në kohën e sotme, veçmas në rrethanat e mësimi të rregullt, që tashmë e zbatojnë shumica e vendeve të zhvilluara dhe edhe shumë të tjera (përfshirë edhe shtetet shqiptare) po përplojnë apo po planifikojnë za zbatojnë së shpejti, realisht sikur hetohet një pamjftueshmëri kohe për të përmbyshur të gjitha ambicet e nxënësit dhe të prindit, veçmas ato që kanë lidhje më të afërt me edukimin e arsimit plotësues fushash të ndryshme e që, ndër të tjera, lidhen edhe me lojën e argëtimit. Në të vërtetë, kjo kohë e mbetur, në rend të parë, ju mundëson atyre, po ashtu, zhvillim sa më të plotë shëndetësor, emocional e shoqëror. Janë një mori veprimtarish të cilat mund të zhvillohen dhe sigurisht paraqesin interes për zhvillimin e gjithmbarshëm të nxënësit, si p.sh. afinitetet e ndryshme artistike e krijuese (art, muzikë, sporte, lexime plotësuese, kohë në medie e teknologji digjitale / rrjete sociale, portale, chat-e/ e hobi të tjera), takime e vizita, nevoja për jetë në familje, kohë të lirë spontane, programe kulturore, vullnetarizëm etj. dhe, ndonjë më shumë e ndonjë më pak, gjithnjë kërkojnë praninë e përkujdesjes së familjes-prindit dhe koordinimin e kësaj pranie me mësuesin/en dhe subjekte të tjerë të shkollës. Pra, sot shkolla, si në vendin pritës si në Atdhe, e ka mjaft të vështirë të ndërtojë paradigmen sa më reale e sa më të pranueshme, e cila do ta kishte të pashmangshme zhvillimin brenda një

baraspeshe veprimesh e ndikimesh ndërmjet arsimit formal (mësimi të rregullt), kohës së lirë dhe teknologjisë (kryesisht digjitale). Didaktika moderne gjithnjë e më tepër mbështetet edhe në të vërtetën biologjike të njeriut (lexo edhe nxënësit, fëmijët) si një homo ludens (njeriu si krijesë me prirje të lindur për lojë). Së këndejmi, sistemet më të përparuara arsimore në botë i atribuohen mjaftueshëm teorisë ludike për shkollën.

## 2. NXËNËSI SHQIPTAR NË DIASPORË DHE LUFTA E PËRHERSHME PËR KOHËN E LIRË

Nëse në Atdhe kjo kohë mund të përshtatet e të koordinohet më lehtë ndërmjet subjektsh të shkollës, në diasporë racionalizimi i saj është më kompleks dhe i nënshtrohet ndikimit edhe të faktorëve të tjerë të shkollës, duke filluar, së pari, nga vetë profili i shkollës, kërkesat, përmbajtjet, parimet e qëllimet kurrikulare të shtetit pritës. Është e natyrshme që në masë të caktuar të ballafaqohemi me një 'konflikt' apo të themi vështirësi koordinimi e racionalizimi në raport me qëllimet e edukimit plotësues identitar që mund dhe duhet të ofrojë shkolla. Zakonisht shkollat, qofshin ato formale të shtetit pritës (në ato pak vende apo njësi federale vendesh ku mësimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare është i integruar brenda sistemit) apo sosh të formave të vetorganizimit vullnetar shqiptar, do të ndodhen në këtë vorbull kontradiktash për të kërkuar dhe gjetur kohën më optimale për ndjekjen e mësimi identitar apo, siç quhet zakonisht sot, të mësimi të gjuhës (amtare) dhe të kulturës së prejardhjes. Pra, për ta pasur, mbajtur e përshtatur nxënësin/fëmijën brenda 'kornizës' së paracaktuar nga faktorë e subjekte të shumë të shkollës (shtet pritës, shtet i prejardhjes, shoqëri, familje, mësues, prind etj.) sikur zhvillohet një luftë edhe për kohën e tij të lirë, e cila, në të vërtetë, në kushtet bashkëkohore duket gjithnjë e më e paktë. Në këtë kontekst, koha e lirë në funksion të mësimi të gjuhës dhe të

kulturës së prejardhjes përgjithësisht jo vetëm që do të zhvendoset (respektivisht e para do të viktimizohet) në kohë të papërshtatshme (ose në orët e vona të pasditeve, ose gjatë fundjavës), por do të ndeshet edhe më tej me reduktime pothuaj se drastike. Së këndejmi, analizat serioze të përfshirjes së nxënësit shqiptar në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës së prejardhjes, këtë e kanë afishuar edhe si njërin prej faktorëve të përqindjes gjithnjë e më të ultë të saj (përfshirjes).

Sot në botë, respektivisht në shtetet ku shtrihet diaspora shqiptare, vetëm në pak vende apo njësi federale vendesh mësimi i gjuhës amtare dhe i kulturës së prejardhjes është i integruar në sistemin e rregullt formal dhe vetëm kushtimisht (pra varet prej vullnetit të lirë) është i obliguar për nxënësit me sfond migrimi, kështu që, në të vërtetë, në shumicën e vendeve kohën e lirë të nxënësit shqiptar në diasporë duhet parë edhe në dy linja të tjera të pranishme aktualisht; a) kohë e lirë pas mësimi të rregullt në shkollën formale në të cilën mungon mësimi i gjuhës dhe i kulturës së prejardhjes së nxënësit me sfond migrimi dhe b) kohë e lirë e nxënësit edhe pas mësimi plotësues (zakonisht 2-3 orë në javë) në Shkollën e Shqipe, gjithsesi si plotësim i saj në ambiente e forma të tjera edhe jashtëshkollore. Janë këto realitete të ndryshme të cilat kërkojnë edhe qasje të veçanta subjektsh; më komplekse, më komplementare.

Në rrethanat aktuale, kur mungon mbështetja e përkujdesja e mjaftueshme e shtetit të prejardhjes (shteteve shqiptare) për zhvillimin identitar të nxënësit shqiptar, respektivisht mbështetja e asaj që e quajmë Shkolla Shqipe në Diasporë, edhe 'beteja' për kohën e lirë të nxënësit zhvillohet në kushte pothuaj se të pabarabarta, sado që kjo (betejë) në të vërtetë është beteja për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare si bërësit kryesorë të identitetit. Kjo i bie që faktori shqiptar (qoftë ai prindi,

mësuesi, hapësira, kushtet etj.) nuk i posedon premiset themelore të një veprimi me efekte të kënaqshme, respektisht veprimet e faktorit shqiptar vuajnë nga jokonsistenca e veprimit, iu mungon baza materiale e profesionale, janë projekte të pamotivuara e jo joshëse për nxënësin, nuk e gëzojnë përkujdesjen e duhur familjare dhe, si të tilla, në një konkurrencë të pabarabartë me koleksionin e ofertave e të mundësive që ia ofron nxënësit shkolla e vendi pritës, nuk e kryejnë dot rolin e tyre të dëshiruar.

Megjithatë, gjithnjë duhet të kërkojmë e të gjenden kohë, mjete, mundësi e potenciale për mirëpërdorimin e kësaj kohe, sepse, në këtë mënyrë do të shijohen edhe rezultatet e edukimit indentitar. Ndërkaq, ajo që e quajmë ndërgjegje kulturore (kombëtare) dhe, pse jo, edhe krenari e vetëdije e përkatësisë (etnicitet) do të jetë e qetë dhe e përmbytur. Si në rrafsh personal, si në rrafsh kolektiv. E për këtë, një ndërveprim faktorësh është më se i nevojshëm. Natyrisht, së paku për kohën e lirë, përgjegjësia kryesore i përket prindit/familjes.

### 3. ROLI I PRINDIT NË MBËSHTETJEN E ORIENTIMIT TË SHFRYTËZIMIT TË KOHËS SË LIRË

Thënë përmbledhtas, roli i prindit është vendimtar dhe shtrihet në tri rrafshë: moral, emocional dhe kulturor. Prandaj, s'do mend, guxojmë të themi se ai (prindi) në këto fusha ka detyrime të veçanta dhe pothuaj të pazëvendësueshme. Në këtë ndërveprim rrafshesh a faktorësh natyreshëm e gjejmë edhe qëllimin themelor për një edukim identitar sa më të plotë e të shëndetshëm, respektivisht zhvillimin e kompetencave gjuhësore e kulturore të nxënësit (fjala është për gjuhën e kulturën e prejardhjes), duke krijuar, në këtë mënyrë, premiset normale apo terrenin e domosdoshëm edhe për kompetencën ndërkulturore. Fundja, janë këto dy kompetencat të cilat, të ekuilibruara mjaftueshëm e karakterizojnë profilin e nxënësit modern në një shoqëri moderne.

Më tej, do të pajtohemi që roli i prindit në edukimin identitar të nxënësit shqiptar në diasporë është i shumanshëm dhe mjaft kompleks. Në rrethanat e ndryshme dhe plot sfida kulturore, gjuhësore etj. të jetës dhe të zhvillimit të fëmijës në shtetin

pritës, prindi i ndërgjegjshëm, përmes ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare, të mbështetjes së socializimit dhe të komunikimit të hapur në të gjitha rrafshet, i mundëson atij (fëmijës) ta ndërtojë identitetin e tij të qëndrueshëm shqiptar, vetëdijen dhe krenarinë e përkatësisë. Përkrah ose edhe pavarësisht prej Shkollës Shqipe ose shkollës formale ku mësohet edhe gjuha dhe kultura e prejardhjes, prindi i ndërgjegjshëm aktivitetin e tij të përditshëm duhet ta drejtojë në shumë plane. Ja disa sosh:

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, duke nxitur e krijuar rrethana për mësimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe në familje dhe edhe më tej, duke iu mundësuar fëmijëve praninë në kultivimin e traditave e të zakoneve me vlerë identitare, praninë e pjesëmarrjen në ngjarje e familjare e shoqërore (fizikisht dhe edhe përmes komunikimeve virtuale online), festivale e takime të tjera, realisht ke kontribuar në ruatjen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore kombëtare;

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë dhe fëmijët tuaj, duke u lidhur dhe duke i forcuar marrëdhëniet me familje të tjera shqiptare, duke krijuar lidhje me grupe të ndryshme kulturore të kulturës kombëtare dhe jo vetëm, duke qenë të pranishëm në organizime e takime që kultivojnë kulturën kombëtare dhe jo vetëm, realisht ke bërë shumë në socializimin e fëmijës, një proces ky shumë i rëndësishëm;

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, duke iu mundësuar fëmijëve shkollim plotësues për gjuhën shqipe e kulturën shqiptare, duke iu mundësuar pjesëmarrjen e duhur në veprimtari të ndryshme të cilat kanë vlerë të çmuar identitare (valle, muzikë, sport, këngë etj.), ke ndihmuar shumë në edukimin dhe zhvillimin e tyre identitar;

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, ke detyrim të përhershëm për bashkëbisedim për tema identitare në nivele të duhura familjare e të tjera, gjithnjë përmes komunikimit të hapur për proceset dhe ndryshimet kulturore dhe ballafaqimet e përditshme të

fëmijës me to, në mënyrë që fëmija sa më lehtë e sa më shumë të mësojë për identitetin e tij për të fituar, në këtë mënyrë, edhe kompetencën e duhur për zotërimin e sfidave, komplekseve e paragjykimëve jo të pakta në raportet komplekse të jetës e të komunikimit ndërkulturore në një shoqëri gjithnjë e më tepër shumëkulturore;

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, duke mbështetur, nxitur e afirmuar vlerat personale e kolektive të fëmijës shqiptar (veçmas të krenarisë së përkatësisë shqiptare), në të vërtetë i ke ndihmuar në zhvillimin e vetëbesimit, aq shumë i nevojshëm për zhvillimin e plotësimin e vazhdueshëm të identitetit të tij autentik, burimor;
- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, me shembullin personal dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes, gjithnjë duhet ta kesh në mendje se realisht je ura e parë dhe e sigurt e lidhjes së fëmijës me identitetin burimor shqiptar, së këndejmi edhe si roje e sigurt e gjuhës shqipe dhe e kulturës shqiptare;

- Ti, si prind me përgjegjësi e krenari të plotë, duhet ta marrësh mbi vete rolin jo të lehtë, por fisnik e patriotik, të udhëheqjes apo të bashkudhëheqjes (menaxhimit) të kohës së lirë në funksion të zhvillimit identitar të fëmijës, duke i nxitur e koordinuar veprimet e aktivitetet e larmishme e të mundshme (biseda të vazhdueshme në tema identitare, përkrahje e mësuesit të Shkollës Shqipe dhe afirmim të saj, përkujdesje e përhershme për përdorimin e gjuhës shqipe në lojë, nxitje e leximit në gjuhën amtare, sa më shumë muzikë e film e medime të tjera me tema gjuhën, kulturën e trashëgiminë kombëtare, prani sa më e madhe dhe në role edhe krijuese në veprimtari publike e interne të komunitetit shqiptar, takime e vizita në nivele familjare, vizita sa më të shpeshta e mirë të planifikuara në Atdhe, mirëpërdorim të komunikimit përmes rrjeteve sociale e chat-ve të shumta, mirëpërdorim të intelegjencës artificiale etj.) e një det mundësish të tjera.

Sistemi i kamerave (CCTV)

Alarmi kundër vjedhjes dhe zjarrit ( Intruder & Fire alarms)

Kontroll i qasjes (Access control)

Menaxhimi i orarit të punës (Time & Attendance systems)

Instalime të infrastrukturës LAN ( LAN infrastructure installation)

Sistemi i menaxhimit të ndërtesave (Building management systems - BMS)

Sistemi i adresimit publik (Public address systems)



+383 49 514 600



info@inetkosova.com



Rr. Mirjane Dragovic p.n.,  
Çagllavicë, Prishtinë, Kosovë



INET



INET – Kosovë



inetkosova



INET (Prishtina, Kosovo)

**DYER PËR GARAZHA**



**GERMAN TORE**

Përfaqësues nga firma:

**novoferm**



**+383 45 338 157**



German Tore



germantore



info@germantore.com



# LAUFEN Në GOGAJ



Brandi prestigjioz zviceran **Laufen**, i njohur për cilësinë dhe dizajnin e produkteve sanitare, ka zgjedhur Gogaj si partnerin e saj për tregun lokal, për shkak të përvojës dhe reputacionit të kompanisë.

Me mbi 34 vite në treg, Gogaj është sinonim i profesionalizmit, korrektesisë dhe shërbimit cilësor - vlera që përputhen në mënyrë perfekte me standardet e larta të Laufen. Kompania ka infrastrukturën, eksperiencën dhe kapacitetin për të siguruar që produktet e Laufen të arrijnë te klientët me kujdes maksimal dhe me garanci. Ky bashkëpunim tregon besimin e markave të njohura botërore te Gogaj si partneri ideal për të ofruar produktet më të mira në tregun shqiptar dhe rajonal. Gogaj është zgjedhja e besueshme për cilësi zvicerane.

## 1

### KUSH JEMI?

Një emër që përfaqëson përkushtim, cilësi dhe traditë. **Gogaj** me 34 vite përvojë në shërbim të klientëve, kanë ndërtuar një themel të fortë mbi besimin, profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj çdo detaji.

## 2 ÇFARË OFROJMË?

Në Gogaj, ofrohet çdo gjë për shtëpinë tuaj, duke mbuluar çdo nevojë me cilësi dhe përvojë.

- **Hidrosanitari & Qeramikë** - Zgjidhje moderne dhe funksionale për banjën tuaj.
- **Ndriçim** - Dritë dhe stil për çdo ambient.
- **Ngrohje Qendrore** - Sisteme efikase për komoditet gjatë gjithë vitit.
- **Mobileri** - Dizajn i menduar për rehati dhe funksionalitet.
- **Elektroshtëpiake & Kuzhina** - Teknologji praktike për jetën e përditshme.
- **Kopsht** - Mobilje kopshti dhe aksesore.
- **Bau** (materiale ndërtimi) Gjithçka për ndërtim dhe rinovim të sigurt.

## KU NDODHEMI? 3

**Gogaj** është afër jush -si fizikisht, ashtu edhe online.

**Deçan** -Lokacioni i parë dhe vendi ku filloi historia 34 -vjeçare.

**Kompleksi Goga Pejë** -Një qendër moderne me gamë të plotë produktesh për shtëpinë tuaj.

**Online** - Tani gjithçka që ofrojnë mund ta porositni lehtësisht edhe përmes platformës dhe rejteteve sociale online, nga komoditeti i shtëpisë suaj.



# KËSHILLA PËR FOTOGRAFITË DHE FILMIMET NË SHESHE

Në epokën e smartfonëve dhe mediave sociale, çdo qytetar mund të bëhet papritur kameraman, duke xhiruar dhe publikuar video nga hapësirat publike. Në hapësirat publike të Kosovës xhirimi i paautorizuar është i ndaluar dhe në rastet kur xhirimi abuzohet qytetarët mund të gjobiten e madje edhe të arrestohen. Në rregullat ligjore parashihet se para çdo fotografimi apo xhirimi qytetarët duhet të japin pëlqimin e tyre. Ky rregull i përjashton figurat publike, zyrtarët dhe politikanët, të cilët filmohen nga mediat për punën e tyre. Por, jo rrallëherë, qytetarët xhirohen pa pëlqimin e tyre në sheshe, në parqe apo në rrugë, dhe pamjet përdoren si ilustrime ose për qëllime mediatike, pa asnjë interes publik.

Qytetarët që pretendojnë se privatësia e tyre është cenuar

mund të parashtrojnë ankesë në AIP, duke ofruar prova të dokumentuara, si fotografi, video, ose dëshmi të dëshmitarëve. Në rastet kur shkelësit janë media, mund të drejtohen te KPM-ja ose te KMSHK-ja, të cilat vendosin mbi respektimin e kodit etik dhe, në rastin e KPM-së, mund të shqiptojnë edhe gjoba.

Ndërkohë, filmimi i paautorizuar në ambiente ku ka prirje të thellë për privatësi mund

të përbëjë edhe vepër penale, e ndëshkueshme deri në 3 vjet burg. AIP ka identifikuar mbi 6,000 kamera të hapura në internet në Kosovë, duke rikonfirmuar se intervistimi i qytetarëve pa pëlqimin e tyre përbën shkelje ligjore. Prandaj, mbrojtja e privatësisë në hapësira publike është një drejtim i rëndësishëm i ligjit dhe mekanizmave rregullues, për të ruajtur dinjitetin dhe të drejtat themelore të qytetarëve.



# BËJA VETËS NJË TË MIRË DUKE U KUJDESUR PËR LËKURËN TËNDE!

## Shërbimet tona

- ✓ Kirurgji Plastike
- ✓ Gjinekologji
- ✓ Dermatologji
- ✓ Shërbime Estetike

Me 13 vite përvojë, që nga viti 2012 kujdesemi për lëkurë të shëndetshme në të 2 klinikat në Prishtinë.

**Prof. Lec.**  
**Krenar Dobroshi**





# BOTA I DHA LAMTUMIRËN IKONËS SË MODËS GIORGIO ARMANI

**N**ë moshën 91-vjeçare, ikona e modës Giorgio Armani ka ndërruar jetë. Stilisti Armani njihej, përgjatë dekadave të praktikës së tij, për krijimin e një estetike tipikisht italiane në veshje, si dhe për ngritjen e tapeteve të kuq të Hollywood-it në një nivel të ri.

I lindur në vitin 1934, në qytetin verior italian Piacenza, Armani nuk tregoi interes profesional për modën deri në vitin 1957. Pas studimeve në mjekësi dhe një periudhe në ushtri, ai gjeti një punë si dekorues vitrinash në La Rinascente në Milano — një hap që do ta lidhte përgjithmonë me kryeqytetin italian të modës.

Në vitin 1964, stilisti Nino Cerruti i dha mundësinë të dizajnonte veshje për meshkuj. Pikërisht aty Armani u njoh me konceptin e xhakëtës së pastrukturuar, që më vonë do ta perfeksiononte dhe do ta bënte të famshëm.

Ndërkohë, ai u njoh me arkitektin Sergio Galeotti, i cili do të bëhej partneri i tij në jetë dhe biznes. Në vitin 1975, ata themeluan markën Giorgio Armani. Koleksioni i parë i veshjeve për meshkuj gjeti sukses në SHBA dhe u pasua me koleksionin për gra, që solli një estetikë androgjene.

Xhaketat e tij tërhoqën vëmendjen e Hollywood-it. Në vitin 1980, Richard Gere veshi një kostum Armani në filmin American Gigolo, duke e kthyer atë në simbol statusi. Yje të shumtë, si Arnold Schwarzenegger, Sophia Loren, Jodie Foster, Sean Connery dhe Tina Turner, u shfaqën me krijimet e tij. Rivaliteti i tij me Gianni Versace-n në vitet '80 u bë një nga konkurrencat më ikonike në modën italiane.

Pas vdekjes së Galeottit në vitin 1985, Armani mbeti aksionari i vetëm i kompanisë. Ai më vonë zgjeronte



markën me linja si Emporio Armani, Armani Jeans, Armani Exchange dhe Armani/Casa, si dhe me hotele luksoze në Milano dhe Dubai.

Një adhures i sportit, ai bleu klubin e basketbollit Olimpia Milano në vitin 2008 dhe krijoi linjën sportive EA7, e cila më vonë u përdor për uniformat e ekipeve italiane në Lojërat Olimpike të Londrës 2012, Rio 2016 dhe Tokio 2020. Ndikimi i Armanit në modë vijon edhe sot. Kostumet e tij të përjetshme, të cilat ofruan grave një alternativë të fuqishme dhe elegante në punë dhe në jetën publike, mbeten të preferuara nga shumë yje të njohura.

Armani u nderua me dhjetëra çmime gjatë karrierës së tij, përfshirë titullin Officer i Madh i Urdhrit të Meritës së Republikës Italiane në vitin 2021 dhe një Çmim për Arritje në Jetë nga Këshilli i Stilistëve të Modës së Amerikës. Në vitin 2002, ai u emërua Ambasador i Vullnetit të Mirë për agjencinë e OKB-së për refugjatët (UNHCR).

**ROCK  
YOUR  
SPACE**



**S O L O S**

[www.solos.studio](http://www.solos.studio)  
f i solos.studio

**FURNITURE  
LIGHTING  
& MORE**



 **KERASAN**



**The beauty  
remains eternal**

[www.kerasan.net](http://www.kerasan.net)  
f i kerasankosova

# GJIROKASTRA, QYTETI I GURTË QË JU LË KUJTIME TË PAHARRUARA

Jo rastësisht, monumentet në mbrojtjen e UNESCO-s janë gjithmonë të veçanta dhe një eksperiencë e paharruar kur vizitohen.

E shpallur si trashëgimi botërore në dhjetor të vitit 2005, Gjirokastra ruan në zemrën e saj stilin e jetës disa qindravjeçare të banorëve të jugut të Shqipërisë.

Nuk ka një datë të saktë se kur nisi ndërtimi i qytetit, por arkitektura e tij është ndër më të veçantat në mbarë globin. Shtëpitë e gurta me kulmet e thepisura, të cilat qëndrojnë të renditura njëra mbi tjetrën në shpatet e malit, krijojnë një peizazh të veçantë e përrallor.

Në rrugicat e ngushta të përshtatshme për këmbësorë dhe makina të vogla fshihen historitë mijëravjeçare të qytetit dhe tregimet për jetën e tij, të njohur si qyteti i magjive të fshehta.

Të paktën kështu përshkruhet qyteti në librin “Kronikë në Gurë” të Ismail Kadaresë, njëra nga kryeveprat e letërsisë shqipe.

Shkrimtari më i madh i letërsisë shqipe, Ismail Kadare, u lind në Gjirokastrë dhe ua kushtoi librin



e tij “Kronikë në Gurë” ngjarjeve të përjetuara gjatë luftës botërore në qytetin e tij të lindjes.

Të pasionuarit e veprave të Kadarese do t’i ndjejnë si të jetuara rrugët e qytetit qysh në vizitën e parë. Kalldrëmet, shtëpitë, kapakët e dritareve, e deri te macet e qytetit, janë po të njëjtat, si në përshkrimet e Kadarese.

Shtëpia e shkrimtarit, e djegur dhe e restauruar, është shndërruar në një muze, në të cilin vizitorët i pret një përvojë e papërjetuar.

Çdo hapësirë e shtëpisë

shoqërohet me dëgjimin e kapitujve të librit “Kronikë në Gurë”, i risjellë nga një narrator, i cili lexon librin në mënyrë brilante.

Vizitat në bodrumin e shtëpisë qilarin apo depozitën e ujit janë përjetime që do t’ju lënë në mendjen tuaj një përjetim të rrallë.

“Shtëpia në të cilën u rrit Kadareja është përdorur nga disa familje të tjera, pasi shkrimtari u zhvendos në Tiranë, ndërsa pas viteve 90-ta u dogj aksidentalisht”, rrëfen cicërujesja e muzeut. Ajo rikujton se shkrimtari vendosi që pronën e familjes së tij t’ia



falë qytetit, i cili më pas investoi në restaurimin dhe konservimin e historisë. E mbrojtur nga UNESCO, Gjirokastra është bërë qendër e turizmi të zonës. Kalaja disa shekujsh e qytetit është një eksperiencë e paharruar për vizitorët, ndërsa muzetë e qytetit

janë të shumtë, përfshirë muzetë që dokumentojnë të kaluarën e komunizmit. Qyteti ishte vendlindja e njeriut më të rëndësishëm në 50 vitet e diktaturës komuniste. Enver Hoxha, lideri i Partisë Komuniste të Shqipërisë, lindi në këtë qytet.

Në rrugët e qytetit ka memoriale të luftës së partizanëve, por edhe kujtimi për njërin nga figurat më të rëndësishme të rilindjes kombëtare, Qerqiz Topullit.

Ai ishte pjesë e Lëvizjes për çlirimin e Shqipërisë në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX.

### **Përjetimi i Gjirokastrës moderne**

E ndërtuar me gurë, ku përpos mureve edhe pullazet janë nga guri, Gjirokastra ka ruajtur pamjen e saj duke iu përshtatur modernes.

Hotelet dhe restorantet e zonës të krijojnë përshtypjen që po jeton në një kohë tjetër, ndërsa enterieri i skalitur në dru artizanal të kujton jetesën e shekujve XVIII apo XIX.

E tërë infrastruktura e qytetit është dizajnuar për të ruajtur historinë dhe arkitekturën, ndërsa rrugicat e vogla, të ndriçuara lehtë janë bërë ideale për shëtitjet gjatë mbrëmjeve.

Skaj rrugëve restorantet e vogla janë një zgjidhje



e përsosur për ushqim dhe pije për pushuesit.

Është e dukshme që interesimi për Gjirokastrën nuk është i madh nga turistët vendorë. Turistë nga Gjermania, Anglia, Holanda apo vendet e tjera të Evropës, janë ata që dominojnë vizitorët e qytetit.

Ata shijojnë bukurinë, çmimet e lira dhe ushqimet e shijshme të zonës.

Qyteti i gurtë, edhe pse atraktiv, ende nuk ka kaluar në një zonë luksoze pushimi, me çmime të shtrenjta. Hotelet e zonës janë të përballeshme, ndërsa pijet dhe ushqimi krahasohen me çmimet normale në gjithë Shqipërinë.



**Tradita që shijohet në sofër**  
**Vizita në Gjirokastrë nuk është e plotë pa i provuar ushqimet e saj karakteristike. Lakrorët me hithra, qifqitë e famshme – topthat e orizit të fërguar, dhe ëmbëlsirat tradicionale, të përgatitura me shumë kujdes, i japin shije një udhëtimi që përndryshe do të ishte vetëm vizual.**



#### Këshilla praktike

Gjirokastra rekomandohet të vizitohet në ditët më të freskëta, pa diell të madh, për shkak të vapës. Për shkak të rrugëve me kalldrëm, këpucët rekomandohen të jenë të rrafshëta dhe pa take. Dyqanet kryesisht pranojnë pagesa në euro dhe pjesa më e madhe e tyre kanë pajisje për pagesa me karta krediti. Në dyqanet e suvenireve vizitorët do të gjejnë shumë dhurata për miqtë e tyre. Produktet janë kryesisht të punuara me dorë.

**LIDERI I DËRGESAVE**  
**NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE MAQEDONI TË VERIUT**

**POSTMAN**  
Postë e shpejtë

# TRANSPORT

PËR MALLËRA DHE AUTOMOBILË

KOSOVË 🚛 ZVICËR 🚛 KOSOVË



## SHËRBIMET:

- ✓ Përvojë shumëvjeçare
- ✓ Siguri maksimale
- ✓ Infrastrukturë moderne
- ✓ Profesionalizëm
- ✓ Kapacitete të mëdha
- ✓ Çmime konkurruese

ZVICËR:  
+41 76 700 2121 | +41 79 640 1306

KOSOVË:  
+383 44 336 987 | +383 49 227 200

# ibas

www.ibas.world

038 600 300

## MOS PAGUAJ provizion për me çu pare në Kosovë!

### Si funksionon?



- Familjari yt hap një llogari IBAS në Kosovë;
- IBAS i gjeneron një konto numër (IBAN anglez) me qasje në SEPA;
- Ju transferoni nga konto numri juaj nga cilado bankë në Evropë, në konto numrin e familjarit tuaj që e ka hapur në IBAS;
- Paratë mbërrijnë brenda sekondave në Kosovë;
- Ju nuk paguani provizion, sepse transferi juaj llogaritet si brenda Zonës Ekonomike Evropiane;
- Familjari yt paguan me Mastercard të IBAS nëpër dyqane ose i tërheq paratë, PA PROVIZION, në bankomatët e cilësdo bankë në Kosovë.



### Llogaria **PREMIUM**

- IBAN të Kosovës dhe IBAN të Anglisë me qasje në **SEPA** (Sistemin e pagesës të Bashkimit Evropian);
- Dy transfere **PA TARIFË**, për çdo muaj nga Bashkimi Evropian;
- Aktivizim me një klik të 750 eurove kredi për pagesa, **PA INTERES** për 3 muaj;
- Kartelë të Mastercard për realizimin e pagesave në POS, **PA TARIFË**;
- Dy tërheqje në muaj, **PA TARIFË** në bankomatët e çfarëdo banke në Kosovë.

### Llogaria **REMITENCA**

Kujdesi Shëndetësor

- IBAN të Kosovës dhe IBAN të Anglisë me qasje në **SEPA** (Sistemin e pagesës të Bashkimit Evropian);
- Sigurim shëndetësor spitalor **deri në 25,000 euro**;
- Dy transfere **PA TARIFË**, për çdo muaj nga Bashkimi Evropian.



Skano këtë QR code për ta hapur ueb faqen dhe **dërgo tek familjari yt** për ta instaluar aplikacionin e IBAS dhe hapur **konto numrin online**.

Hapja e llogarisë në IBAS është pa pagesë.



# LIDERËT KOMUNISTË, ME PRIVILEGJE EDHE NË BUNKERË

“Një banjë e veçantë për liderin dhe një dhomë e veçantë për të”, këto ishin dy privilegjet kryesore që do t’i kishte ish-diktatori Enver Hoxha në rast se Shqipëria do të ishte cak i një sulmi bërthamor dhe ai do të duhej të strehohej në bunkerin e Gjirokastrës.

I vetizoluar nga pothuajse të gjitha anët e botës, regjimi diktatorial i Enver Hoxhës nisi investimet masive për ta mbrojtur Shqipërinë edhe nga një sulm i mundshëm bërthamor. Në kohën e luftës së ftohtë, miliarda dollarë u investuan në industrinë e mbrojtjes, ndërsa koncepti i bunkerëve bërthamorë ishte zhvilluar për të garantuar qeverisjen e vendeve në rast të

një sulmi bërthamor.

Buzë një shkëmbi dhe prapa një objekti madh qeveritar, ushtria ndërtoi një vrimë, e cila brenda shkëmbit të nënkalasës shtrin një qytet të tërë pune.

Me 800 metra gjatësi dhe tri dalje sekrete, bunkerin bërthamor i Gjirokastrës do të arrinte të strehonte deri në 300 punonjës, të cilët do të strehonin vendin në rast lufte.

Strategjikisht bunkerët bërthamorë janë kamufluar dhe hyrjet e tyre nuk arrijnë të dallohen nga ajri. Ngjashëm ishte planifikuar edhe në Gjirokastrë. Bunkerin që dikur garantonte mbrojtje në vitet e 90-ta u shkatërrua i tëri, pjesa më e





madhe e infrastrukturës u vodh bashkë me mobilet dhe inventarin.

Por, me një pagesë prej 200 lekësh shqiptarë, cicëruesja e bunkerit, që tash është shndërruar në muze, tregon shumë në turrin që zgjatë rreth 1 orë.

“Bunkerit në hyrje ka tri dyer, njëra prej tyre e betontë dhe dy të tjera masive të çelikut. Ato janë projektuar të mos lejojnë shkatërrimin e bunkerit nga shpërthimet bërthamore”, shpjegon cicëruesja.

E përdorur në Luftën e Dytë Botërore, bomba bërthamore është njëra nga bombat më shkatërruese që ka krijuar njeriu. Radioaktiviteti i saj është vrasës edhe për dekada me radhë pas shpërthimit.

Projektuesit e bunkerit instaluan një sistem, i cili do të mbronte bunkerin nga rrezatimi radioaktiv që shpërndahet me ajër, ujë, ushime apo edhe me materialet që i ekspozohen atij.

“Brenda tunelit kishte një sistem të avancuar të filtrimit të ajrit, i cili mundësonte që grimcat radioaktive të mbaheshin jashtë dhe të kishte oksigjen”, shpjegon cicëruesja. Sistemi tani është jofunksional dhe është një gërmadhë e mbuluar nga ndryshku. Fat të njëjtë kanë pasur edhe gjeneratorët, të cilët ishin dedikuar për prodhimin e energjisë elektrike. Njëri prej gjeneratorëve është zhdukur pas viteve të 90-ta, ndërsa tjetri është i papërdorshëm dhe i mbuluar nga ndryshku.

Tuneli kishte depo të mëdha ushqimi dhe rezerva të ujit dhe llogaritë tregonin që stafi mund të qëndronte më shumë se 6 muaj pa pasur nevojë të ketë furnizime nga jashtë.

Nga zona e menaxhimit të furnizimeve tuneli kalonte në pjesën administrative. Brenda shkëmbit, në thellësi prej mbi 600

metrash, janë gërmuar zyrat në të cilat do të qëndronte stafi i partisë komuniste që do menaxhonte Shqipërinë në rast të sulmit bërthamor.

Mbishkrimet në dyer, si Administrata, Kuadri, Dega ushtarake, ende janë aktive, ndërsa zyrat janë plaçkitur.

Dera kryesore mban emrin “Zyra e sekretarit të parë”. Ky emër i atribuohet drejtuesit komunist të kohës, Enver Hoxhës. “Siç mund të shihet, kjo ka qenë zyrë pune, por edhe zyrë qëndrimi. Ka një tavolinë, një telefon dhe një shtrat të fjetjes”, shpjegon cicëruesja. Nga hapësira, zyra e sekretarit të parë është më e madhe dhe duket se ishte më luksoze për kohën, ndërsa pak mobile që kanë mbetur të pashkatërruara tregojnë që hapësira ishte përgatitur për qëndrim të gjatë.

Në hapësirën e bunkerit lideri komunist kishte vetëm një privilegj. Ai kishte një banjë të ndarë nga stafi. Të tjerët, siç shpjegon cicëruesja, do të përdornin dy banjat e tjera të bunkerit, të cilat janë të ndërtuara në të njëjtin vend.

Ajo shpjegon se bunkerit ishte ndërtuar për të pasur komunikim me jashtë nëpërmjet tuneleve të fshehta, të cilat daljen e kanë brenda hapësirave të Kalasë së Gjirokastrës. Kalaja e gurit ishte llogaritur që do t’u mbijetonte sulmeve dhe bombardimeve.

Në komunikim tuneli kishte lidhjet e telefonit dhe lidhjet e tjera të komunikimit ushtarak, të cilat mundësonin që nga aty të jepeshin urdhra për luftëtarët në mbarë Shqipërinë.

Çdo gjë ishte planifikuar të menaxhohet nga aty, përfshirë edhe mbledhjet e Qeverisë dhe komandës. Për dallim na zyrat normale, në hapësirën e takimeve karriget ishin shumë më të vogla. Të gjithë që merrnin pjesë në



mbledhje do të lexonin çdo ditë parullën e thënë nga Enver Hoxha, ndërsa mesazhi kryesor i vendosur afër tabelës ishte: “Ndërtimi është njëri nga sektorët jetikë për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore”.

Bunkeri i betontë mban në vete një histori të gjatë të fortifikimit dhe investimeve në industrinë e mbrojtjes. Shqipëria shkoi drejt falimentimit dhe një varfërie ekstreme në vitet e 90-ta, për shkak të dështimit të ekonomisë socialiste dhe diktaturës së tmerrshme komuniste.

Në vend ka mijëra bunkerë, ndërtimi i të cilëve kushtoi miliarda dollarë. Deri më tani, Shqipëria ka nxjerrë në shesh ekzistimin e dy bunkerëve bërthamorë. Bunkeri tjetër bërthamor është vendosur në Tiranë. Vizita në bunkerin bërthamor të Tiranës mund të realizohet në kuadër të projektit “BUNK’ART”.

Bunkeri i ndërtuar në periferi të Tiranës është më i madh se bunkeri i Gjirokastrës dhe është i

ndërtuar në 5 kate, me 106 dhoma, salla të mëdha të konferencave, dhe dhomat e gjumit për diktatorin Enver Hoxha, zëvendësin e tij, Mehmet Shehun, dhe liderët e tjerë komunistë.

#### **Bunkerët e Titos vs Enver Hoxhës**

Shqipëria kishte prishur marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe gjendja ishte armiqësuar

deklarativisht në shumë raste.

Të përmendura si të ekzagjeruara, investimet e Shqipërisë në mbrojtje janë minimale po të krahasohen me investimet që Jugosllavia i kishte bërë në vitet e pasluftës së Dytë Botërore.

Fortifikimet jugosllave me bunkerë, edhe pse jo të dukshme në hapësira publike, ishim disa herë më të avancuara dhe



kushtuan shumë më shtrenjtë.

Numri i bunkerëve bërthamorë të Jugosllavisë nuk është bërë publik ende, por luftërat në jugosllavi ekspozuan disa prej tyre.

Njëri nga bunkerët më të mëdhenj të Jugosllavisë së Titos u bë i njohur në kohën e luftës së Bosnjës. Strehimorja bërthamore, e njohur si ARK (Komanda e Luftës Atomike) D-0, ishte një sekret i ruajtur mirë për dekada. Ndërtimi u bë në fshehtësi të plotë, gjatë 26 viteve – midis 1953 dhe 1979. Në rast të një sulmi bërthamor, strehimorja mund të strehonte Titon dhe 350 nga personat më të rëndësishëm politikë e ushtarakë të vendit, duke u ofruar atyre mbrojtje nga një shpërthim bërthamor prej 25 kilotonësh, ndërsa siguronte kushte optimale jete dhe pune, me temperaturë ajri konstante prej 21 deri në 23 gradë celsius dhe lagështi relative të ajrit prej 50 deri në 60 promilë. Për të ndërtuar diçka të tillë u deshën shumë para, rreth 4,6 miliardë dollarë amerikanë. Por, sipas dëshmive të disa punëtorëve, gjithashtu, mori edhe shumë jetë njerëzish. Të gjithë punëtorët transportoheshin me sytë e lidhur deri në vendin e ndërtimit dhe lejoheshin t'i hiqnin



lidhëset vetëm pasi hynin brenda. Kur ndërtimi përfundoi, vetëm 16 persona e dinin për ekzistencën e bunker-it - tre gjeneralë dhe 13 ushtarë që shërbenin në këtë objekt. Të gjithë kishin dhënë betimin për të ruajtur sekretin e vendndodhjes.

Objekti është ndërtuar në formë

patkoi dhe zë një sipërfaqe prej afërsisht 6.400 metrash katrorë, me pikën më të ulët 280 metra nën tokë. Ai përbëhet nga 12 blloqe të lidhura, ku gjenden zona banimi, salla konferencash, zyra, dhoma për planifikim strategjik dhe ambiente të tjera. Objekti ndahet në 3 pjesë kryesore.





## Klinika Dentare Dr. Shkodrani

### KU TEKNOLOGJIA INOVATIVE TAKOHET ME EKSPERTIZË 26 VJEÇARE

#### Sistemi “In-Clinic Laboratory”

##### Pritjet e gjata i takojnë të kaluarës

Me sistemin inovativ “In-Clinic Laboratory” me teknologjinë më moderne nga DentSply Sirona, çdo hap nga marrja e masës në mënyrë digjinale, dizajnimi i dhëmbëve dhe deri tek realizimi i dhëmbëve kryhet brenda klinikës, duke e shkurtuar ndjeshëm kohën e pritjes. Me teknologjinë moderne dhe ekspertizën tonë shumëvjeçare, ne garantojmë që çdo punë të ndërthurë funksionalitetin dhe estetikën në nivelin më të lartë.



#### Implantet dentare nga kirugu me eksperiencë mbi 2 dekada

Dr. Shkodrani është sinonim i profesionalizmit dhe inovacionit në fushën e kirurgjisë maksilofaciale. Me më shumë se dy dekada eksperiencë dhe qasje të avancuar teknologjike, ai garanton trajtime që jo vetëm përmirësojnë funksionin oral, por gjithashtu krijojnë rezultate estetike të përsosura, duke transformuar buzëqeshjet dhe vetëbesimin e pacientëve të tij.



- Mitrovicë
- Prishtinë
- Vushtrri



+383 44-147-641



@drshkodrani



# USHTRIMET QË LUFTOJNË PAGJUMËSINË

**P**agjumësia konsiderohet njëri nga problemet sociale të shekullit 21, por studimet tregojnë që disa ushtrime të thjeshta ndihmojnë trajtimin e këtij problemi serioz.

Shumë njerëz mendojnë që

lodhja e tepruar në palestër apo vrapimi i gjatë mund t'ju ndihmojnë në trajtimin e pagjumësisë, por një studim i revistës MJB Evidence Based Medicine ka dokumentuar se disa ushtrime të thjeshta ndihmojnë në trajtimin e problemit.

Ndër ushtrimet e studiuar, Joga, Tai chi, dhe ecja ose vrapimi treguan dëshmitë më premtuese për të ndihmuar pjesëmarrësit të flinin më shpejt dhe të qëndronin më gjatë në gjumë, me më pak zgjime.

“Dëshmitë në rritje sugjerojnë se aktiviteti fizik i rregullt jo vetëm që përmirëson shëndetin fizik, por, gjithashtu, përmirëson cilësinë e gjumit”, tha Zhi-jun Bu, autori i parë i studimit dhe student doktrate në Mjekësinë Klinike në Universitetin e Mjekësisë Tradicionale Kineze në Nanjing, në një e-mail. “Megjithatë, shumica e studimeve ekzistuese fokusohen vetëm në një lloj ushtrimi, duke munguar krahasime gjithëpërfshirëse.”

“Kërkimi tregon për alternativa





Paruthi, profesoreshë e asociuar e mjekësisë së brendshme dhe pediatriisë në Shkollën e Mjekësisë të Universitetit të Shën Luisit, si dhe zëdhënëse për Akademinë Amerikane të Mjekësisë së Gjumit.

“Pagjumësia afatgjatë mund të vijë nga një sërë shkaqesh mjedisore dhe trashëgimore, përfshirë stresin, zakonet e dobëta të gjumit, dhimbjet kronike, medikamentet ose çrregullimet e tjera të gjumit, si apnea”, theksoi Paruthi. Zakonisht, linja e parë e trajtimit për pagjumësinë përfshin terapinë kognitive-biheviorale, ose CBT, një qasje psikologjike që synon të përshtatë mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e pacientëve rreth gjumit.

potencialisht me kosto efektive dhe pa barna ndaj trajtimeve tradicionale të pagjumësisë dhe të kuptuarit më tej i përfitimeve unike të secilit ushtrim mund të jetë hapi i radhës”, tha Bu, i cili e zhvilloi kërkimin kur ishte duke ndjekur masterin në Universitetin e Mjekësisë Tradicionale Kineze në Pekin.

### Çfarë e shkakton pagjumësinë dhe si trajtohet?

“Në një mjedis klinik, pagjumësia zakonisht diagnostikohet kur dikush ka vështirësi për të fjetur dhe përjeton shqetësime të shpeshta dhe të zgjatura të gjumit tre ose më shumë herë në javë”, tha dr. Shalini

## TRI USHTRIME QË MUND T'I PROVONI PËR GJUMË MË TË MIRË

Nga provat klinike të rastësishme, që ekipi i Bu i analizoi, këto tri aktivitete fizike kishin dëshmitë më të mira për efikasitetin e tyre si trajtim i vetëm për pagjumësinë:



**Yoga:** Dy deri në gjashtë seanca prej 45 deri në 60 minuta në javë për një deri në katër muaj rritën kohën totale të gjumit me pothuajse dy orë në natë dhe ulën rastet e zgjimit pas

gjumit me një orë.

“Yoga mund të promovojë gjumë më të mirë, duke nxitur frymëmarrje të thellë, ndërgjegjësim për trupin dhe një gjendje të qetë mendore, që ndihmon në uljen e stresit dhe ankthit – dy shkaktarë të zakonshëm të pagjumësisë”, sugjeroi Bu.



**Tai chi:** Dy deri në tri seanca prej 45 deri në 60 minuta në javë për tre deri në katër muaj rritën kohën totale të gjumit me më shumë se 50 minuta dhe ulën kohën zgjuar me mbi 30

minuta.

“Arti luftarak kinez përfshin kombinimin e një serie lëvizjesh të rrjedhshme, me ndikim të ulët, me frymëmarrje të ngadaltë dhe të thellë që mund të ndihmojnë në uljen e stresit dhe qetësimin e trupit”, tha Bu.



vlerësimit klinik.



melatoninës (hormoni që rregullon gjumin) dhe promovon gjumë më të thellë dhe më restaurues duke ndihmuar në reduktimin e simptomave të pagjumësisë”, tha Bu.

**Ecja ose vrapimi:** Tri deri në pesë seanca prej 30 deri në 75 minuta në javë për tre deri në gjashtë muaj treguan reduktim të simptomave të pagjumësisë bazuar në sisteme standarde të

**“Ecja ose vrapimi përmirëson gjumin nëpërmjet mekanizmave fizikë dhe emocionalë:** rrit shpenzimin e energjisë, ul hormonet e stresit si kortizoli, përmirëson humurin, nxit prodhimin e

# Unë jam Radio Dukagjini

## një zë që udhëton me ju, në tokë dhe në ajër

Çdo mëngjes, çdo mbrëmje, çdo orë e natës – që nga viti 1999, zëri im është bërë pjesë e jetës në Kosovë. Fillova si një radio lokale, por që nga viti 2001 u rrita në një radiostacion kombëtar. Vetëm një vit më pas, sipas sondazhit të Agjencisë amerikane IREX, u vlerësua si radio më e dëgjuar në Kosovë – dhe këtë dashuri e besim e ruaj edhe sot, me po aq përkushtim.

Unë jam një përzierje e përvojës dhe rinisë. Kam njerëz që kanë qenë me mua që në ditët e para dhe të rinj plot pasion. Programi im është i ndarë në pesë sektorë të qartë: lajme, zbavitje, muzikë, shitje dhe administratë, si dhe produksion. Gjithçka që dëgjoni, është punë zemre dhe profesionalizmi.

Sot, më dëgjojnë jo vetëm në frekuencat tokësore në tërë Kosovën, por edhe online, nga bashkatdhetarët në mërgatë e dëgjues të rinj kudo në botë. Falë teknologjisë dhe aplikacionit tim që mban emrin tim – Radio Dukagjini – jam vetëm një klikim larg.

Më gjeni në këto frekuenca:

**99.7 FM** – Prishtinë e rrethinë

**94.5 FM** – Rajoni i Dukagjinit dhe Prizrenit

**105.1 FM** – Rajoni i Mitrovicës dhe Kamenicës

**104.7 FM** – Rajoni i Pejës dhe Podujevës

**92.7 FM** – Rajoni i Gjiçanit, Kamenicës dhe Prishtinës

**93.2 FM** – Rajoni i Kaçanikut

Dhe gjithashtu në të gjitha rrjetet sociale. Mjafton të kërkonti “Radio Dukagjini”. Nuk do të isha këtu pa ju. Pa dëgjuesit, bashkëpunëtorët, dhe të gjithë ata që më besuan rrugës. Kam shënuar 25 vjet jetë – një çerek shekulli që flet për përkushtim, dashuri për radion, dhe një komunitet që nuk ndalet së bashkëjetuari me fjalën dhe muzikën.

Sepse gjërat e mëdha ndodhin kur bashkëveprojmë.

Me dashuri nga Radio Dukagjini, zani që ju ndjek.



☎ 038 737 373 ☎ 038 737 374

📠 043 777 022 (marketing)

✉ [radio@dukagjini.com](mailto:radio@dukagjini.com)



# NË GP AVIATION JETËSOHET ËNDRRA E PILOTËVE SHQIPTARË

Në fëmijërinë e hershme mijëra fëmijë ëndërrojnë profesionin e pilotit. I vlerësuar si njëri nga profesionet fisnike dhe shumë atraktive, pilotimi kërkon një përgatitje superiore dhe certifikim të vazhdueshëm. Në një vend të shkatërruar nga lufta dhe me infrastrukturë të limituar, mësimi për pilotimin e fluturakeve dhe avionëve në Kosovë është i pamundur. Por ëndrrat

për t'i prekur qiejt nuk i kanë ndalur dy pilotët e GP Aviation, Blin Hoxha dhe Lirik Qerimi, të cilët në akademitë evropiane të aviacionit mësuan pilotimin dhe nga muaji shtator u bënë pjesë e stafit ndërkombëtar të pilotëve të GP Aviation, kompanisë me numrin më të madh të operimeve dhe udhëtarëve nga Aeroporti i Prishtinës.

Blin Hoxha është lindur në Prishtinë, ku ka kryer shkollën fillore dhe të mesme. Me një anglishte të shkëlqyer, ai vazhdoi studimet në Akademinë Evropiane të Aviacionit në Maltë.

“Pasioni im për fluturimin nisi që në fëmijëri. Qysh i vogël i studioja aeroplanët, lexoja për aviacionin dhe madje ndërtova një kokpit të vogël në dhomën time, me ekrane kompjuterësh dhe joystick. Shikoja video e filma pafund për fluturimet, dhe kur u regjistrova në Akademi, tashmë kisha një bagazh të fortë njohurish”, thotë Hoxha.

Ai ka arritur të marrë licencat evropiane të pilotimit, të cilat i mundësojnë operim në mbarë





## ËNDRAT PËR TË ARDHMEN

**K**osova ende nuk ka një shkollë të certifikuar pilotimi për pilotët amatorë, por edhe për pilotët profesionistë. Dy pilotët e GP tashmë kanë një ëndërr: ata synojnë të zhvillojnë programe në Kosovë, të cilat do t'u mundësojnë të rinjve mësimin e pilotimit dhe arritjen e standardeve evropiane të fluturimit.

“Dua të krijoj një vend ku të rinjtë me të njëjtin pasion si unë të kenë mundësinë të ndjekin ëndrrat e tyre, të shohin botën nga lart dhe ta çojnë aviacionin e Kosovës përpara, drejt niveleve ndërkombëtare”, thotë Blin Hoxha.

Industria e aviacionit në Kosovë është shndërruar në një mbështetës të fortë të punësimit dhe ekonomisë lokale. GP Aviation, si operuesi më i madh nga Aeroporti i Prishtinës, punëson mbi 100 qytetarë të Kosovës, të cilët fluturojnë me kompaninë



dhe ofrojnë shërbime në tokë për pasagjerët. Tashmë është e konstatuar se rritja e operimeve nga Prishtina ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e ekonomisë dhe punësimit në Kosovë.

Evropën.

“Sot jam pilot me licencë CPL (Commercial Pilot License) dhe i kualifikuar për Boeing 737. Kam kaluar trajnim rigoroz dhe jam i përgatitur të përballem me çdo sfidë, nga kushtet atmosferike të vështira e deri te vendimarrjet kritike që kërkon profesioni”, thotë Hoxha.

Ai për momentin punon si First Officer, por njëkohësisht kontribuon edhe në departamentin e Flight Operations.

“Kjo më jep mundësinë të zhvillohem profesionalisht në të dy aspektet – si pilot, por edhe në menaxhimin e operacioneve fluturuese. Në GP Aviation kam gjetur një ekip jashtëzakonisht profesional dhe mbështetës, që më motivon çdo ditë të jap më të mirën

time”, thotë Hoxha.

I lindur dhe i rritur në Gjilan, piloti tjetër i GP Aviation, Lirik Qerimi, ka nisur së fundmi operimet me liderin e fluturimeve. Ëndrra e tij fëmijërore është bërë realitet dhe për të, aviacioni nuk është vetëm profesion, por edhe pasion dhe thirrje jetësore.

Pas shkollimit të përgjithshëm në Kosovë, Liriku ndoqi përgatitjen e tij profesionale në Greqi, ku përfundoi studimet për aviacion dhe u pajis me licencën komerciale të fluturimit. Ky ishte një hap vendimtar që i hapi dyert drejt karrierës si pilot. Me përkushtimin e tij dhe me ndihmën e njerëzve adekuatë të aviacionit në Kosovë, ai arriti të certifikohet për Boeing 737, duke e bërë këtë arritje një gur të rëndësishëm kilometrik në jetën e tij profesionale.

**AZET**

# FAST LIFE FOREVER TOUR 2026



**GET  
YOUR  
TICKET**

**STUTTGART --- 09.01.2026**

**MÜNCHEN ----- 10.01.2026**

**FRANKFURT ---- 11.01.2026**

**ZÜRICH ----- 13.01.2026**

**BERLIN ----- 15.01.2026**

**HAMBURG ----- 16.01.2026**

**KÖLN ----- 17.01.2026**



# KOLEKSIONISTËT ANONIMË TË MONEDHAVE QË PRITET TË FITOJNË DERI NË 100 MILIONË EURO

**P**asardhësit e një qifti anonim, të cilët lanë trashëgimi një koleksion me 15 mijë monedha, do të mund të përfitojnë deri në 100 milionë euro nga shitja në ankand e monedhave. Koleksioni me monedha ka vlerë të lartë për shkak të historisë dhe origjinës së tyre.

Ai përfshin monedha nga më shumë se 100 territore në të gjithë botën, që shtrihen nga periudha antike deri në epokën moderne. Por ajo që e bën këtë koleksion, i cili do të dalë në ankand nga Numismatica Ars Classica, edhe më të veçantë është fakti se shumica e monedhave ishin varrosur nën tokë për gjysmë shekulli.



Sipas një njoftimi për shtyp për shitjen e monedhave, i dërguar tek CNN, koleksionisti origjinal – i cili



nuk është identifikuar – filloi të blinte monedha ari pas Krizës së Wall Street-it në vitin 1929. Ai shpejt

zhvilloi “një shije për monedha me interes të madh historik, bukuri dhe rrallësi” dhe në fund kishte në zotërim rreth 15,000 monedha.

Ai dhe gruaja e tij kaluan vitet 1930 duke udhëtuar gjerësisht nëpër Amerikë dhe Evropë, duke mbledhur monedha të rralla dhe historikisht të rëndësishme, ndërkohë që krijojnë edhe një arkiv të detajuar të blerjeve të tyre.

Çifti u vendos më pas në Evropë, pavarësisht hijes së errët që po hidhte partia naziste e Hitlerit mbi kontinent. Megjithatë, koleksionisti duhet të kishte ndër të kërçënimin e afërt, pasi monedhat u paketuan me kujdes në kuti cigare, të cilat më pas u vendosën në kuti alumini dhe u varrosën në tokë - ku qëndruan për pesë dekada.

“Në koleksion përfshihen të gjitha zonat gjeografike dhe përmban monedha jashtëzakonisht të rralla, shpesh në gjendje ruajtjeje që nuk është parë në kohët moderne. Disa lloje nuk janë ofruar kurrë në një ankand publik, duke theksuar rrallësinë e tyre të konsiderueshme”, thuhet në njoftim.

Kur monedhat u rikuperuan nga trashëgimtarët e koleksionistit, ato u ruajtën në një kasafortë banke dhe më pas u prezantuan në



shtëpinë e ankandëve për shitje. Fatkeqësisht, nuk janë dhënë më shumë detaje mbi fshehjen ose zbulimin e monedhave, për shkak të kërkesës së familjes për privatësi.

Regjistrimet e detajuara të koleksionistit e bënë më të lehtë për ekipin e shtëpisë së ankandëve të hulumtonte origjinën dhe vlerën e monedhave, disa prej të cilave mund të gjurmohen deri tek ankandet e koleksioneve më të mëdha të fundit të shekullit 19 dhe fillim të shekullit 20.

Ndër pikat më të veçanta është një monedhë ari 100 dukatë e Ferdinand III të Habsburgut, e prodhuar në vitin 1629, kur ai ishte arkitrak i Austrisë,

mbret i Hungarisë, Kroacisë dhe Bohemisë. E bërë prej 348.5 gramesh ari të pastër, kjo është një nga monedhat më të mëdha evropiane të arit që janë prodhuar ndonjëherë.

Gjithashtu, përfshihet një set “jashtëzakonisht i rrallë” prej pesë Tomansh, të prodhuara në Teheran dhe Isfahan në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX nga Agha Mohammad Khan Qajar. Janë të njohura vetëm pesë sete të tilla të plota, njëri prej të cilëve ndodhet në Muzeun Ashmolean në Oksford, Mbretëri e Bashkuar.

Arturo Russo, drejtori i Numismatica Ars Classica, tha në njoftim: “Shtirja e madhe dhe cilësia e shkëlqyer e monedhave të ofruara, numri i madh i rrallësive dhe historia magjepse e formimit të koleksionit do të bëjnë këto shitje një pikë referimi në historinë e numizmatikës.”

David Guest, drejtori i David Guest Numismatics dhe këshilltar i koleksionit, tha në njoftim: “Kur erdhi puna për katalogimin e monedhave britanike nga Koleksioni Traveller, më duhej të rrija duke i kapur vetes për t’u siguruar që nuk po ëndërroja.





# PËRSHTYPJET E DUA LIPËS PËR VIZITËN NË “REPORTING HOUSE”

Në muajt e verës muzeu më i madh në Kosovë për të kaluarën, “Reporting House”, ka mirëpritur mijëra vizitorë, përfshirë vizitorët më të famshëm të kryeqytetit.

Krahas diplomatëve, shkencëtareve e studiuesve, muzeu është vizituar nga shumica e artistëve që performuan në jetën e pasur kulturore të Prishtinës gjatë verës.

Ylli i muzikës botërore, Dua Lipa, gjatë turit të saj artistik në Prishtinë, rezervoi kohë për të vizituar muzeun.

E shoqëruar nga Dukagjin Lipa,

babai i saj, dhe Callum Turner, aktor i famshëm dhe i fejuari, Dua dëgjoi rrëfimet për muzeun dhe historinë që transmeton ai. Në pritjen e organizuar nga producentja e muzeut, Jeta Xharra, kuratori i muzeut, Gazmend Ejupi, gazetarja Donika Shahini dhe nga stafi e vullnetarët e “Reporting House”, ekipi mori një shpjegim të gjatë për historinë e muzeut që dokumenton rezistencën gjatë viteve të 90-ta.

Në pak fjalë, Dua Lipa tha shumë për muzeun. “Keni bërë një punë të mrekullueshme për të treguar historinë e Kosovës në këtë

muze”.

Dukagjin Lipa falënderoi që muzeu u hap përtej orarit të tij dhe tha që kjo vizitë është realizuar për shkak të respektit për punën e bërë me këtë muze. Callum Turner u interesua për xhirimet e trupave speciale britanike, ‘Paratroopers’, të cilët kishin ardhur në Kosovë në ditët të para të hyrjes së NATO-s dhe shiheshin në xhirime duke bërë skenimin e terrenit për mina në Prishtinë.

Derisa Dua i tregonte për lagjet e njohura të Prishtinës, që i shihte në xhirimet e vitit 1999, të bëra nga BBC. Donika Shahini, gazetarja

që e kishte ruajtur fletoren e fëmijëve të Jasharëve, tha se ishte fantastike me çfarë interesimi, kurioziteti dhe modestie Dua dëgjoji rrëfimin e saj për fletoren e shpëtuar nga shtëpia e Jasharëve, të cilën e ka ruajtur për këtë muze.

“

**“Kjo më bëri shumë të lumtur, që një njeri si ajo, që ishte e angazhuar aq shumë me festivalin dhe koncertin e saj, të cilin e kam parë dhe më ka bërë të lumtur, gjeti kohë të vizitojë muze dhe të interesohet për punën tonë”, tha Shahini. Jeta Xharra, bashkëthemeluesja e muzeut “Reporting House”, tha se kanë pasur një fluks të njerëzve që e kanë vizituar muzeun për shkak se kanë ardhur në Kosovë për Sunny Hill.**

“Pra, kemi pasur mundësi t’u flasim për historinë e Kosovës njerëzve që normalisht nuk do të vinin në Kosovë. Kjo tregon që, përtej profesionalizimit të lartë që

është treguar këto ditë nga stafi i kompanisë “Republika”, që e kanë organizuar festivalin Sunny Hill - të cilin e kam vizituar çdo natë - është e hatashme sa e dobishme është treguar familja Lipa për të gjithë ne që jetojmë e punojmë në Kosovë. Thjesht ata na kanë bërë nder duke e promovuar një Kosovë moderne, një rini kosovare që ndihet rehat në lëkurën e vet dhe rehat me histori të vet - e për mua befasi e këndshme ishte sidomos që, pas gjithë asaj lodhje me festival, kjo familje gjeti kohë të interesohet për historinë e Kosovës disa orë para se Dua duhej të

udhëtonte e ta zinte aeroplanin për udhëtimin e mëtutjeshëm të saj. Kjo tregon një fokusim të hatashëm të kësaj familjeje për të bërë mirë jo vetëm për veti, por për Kosovë”, shtoi Xharra. Gjatë vizitës së saj, Lipa me familjarët vizituan edhe Galerinë e “Reporting House”, ku po ekspozohet puna e artistit 18-vjeçar nga Gaza, Hussein al-Jerjawi, e cila titullohet “Fragmente të mbijetesës”.

“

**“Reporting House” është hapur më 10.06.2024 në ish-shtëpinë e mallrave “Gërmia” në Prishtinë dhe pasqyron punën e madhe që kanë bërë gazetarët vendorë e ndërkombëtarë gjatë luftës në Kosovë. Orari i vizitës është gjatë ditëve e marte - e premte, prej orës 10:00 deri në orën 20:00, ndërsa të shtunën prej orës 10:00 deri në 18:00.**



**EXPERIENCE AN UNFORGETTABLE WINE  
TOUR IN THE HEART OF THE RAHOVEC VALLEY.  
EXPLORE STONE CASTLE'S HISTORIC CELLARS AND  
ENJOY GUIDED TASTINGS OF AWARD-WINNING  
WINES CRAFTED WITH PASSION AND TRADITION.**

*Restoring Stone Castle was never just about wine- it was about  
reviving a legacy, rooted in our land, our people, and our future.*  
— **Rrustem Gecaj, Owner & Visionary**

WWW.STONECASTLEWINE.COM  
booking@stonecastlewine.com  
+383 29 276 053  
+383 29 276 051



**JEPNI JETË  
KOPSHTIT  
TUAJ!**

 +383 49 777 406

 [www.lulishtjalabi.com](http://www.lulishtjalabi.com)

 Magjistratja Prishtinë-Ferizaj



**ART**  
MOTION

315+  
KANALE TV

40+ LIGA  
SPORT HD

INTERNET DERI  
500 Mbps

TË GJITHA  
KANALET  
DIGITALB

tring

BIG BROTHER  
VIP KOSOVA

BIG BROTHER  
VIP

*Tjetër nive*

Çdo ligë,  
çdo emocion.



www.artmotion.net 0800 20 500

**kujtesa**

• **290+** Kanale • **30+** Liga sportive • Internet deri në **500Mbps** • **Digitalb**  
• **BigBrother VIP Kosova** • **BigBrother VIP Albania** • Kanalet e **Cinestar**

**Kujtesa** jote,  
përjetim i ri!

0800 400 40  
www.kujtesa.com



DESIGN

REKLAMA 3D

DIGITAL PRINT

ADVERTISING

MATERIALE  
PROMOCIONALE

BRANDING

LED SCREEN

Be Only Premium



+383 (0)38 60 60 68  
+383 (0)45 87 87 87  
+383 (0)45 97 97 97

Highway Prishtina - Shkup 6-th km  
10000 Prishtinë, Kosovë  
info@zhakiadvertising.com  
www.zhakiadvertising.com



POLIKLINIKA SHOSHI

# MBI 35 VITE PËRVOJË NË SHËRBIMIN E SHËNDETIT TUAJ.

Në zemër të kujdesit shëndetësor bashkëkohor në Kosovë qëndron Poliklinika Shoshi, me mbi tri dekada përkushtim dhe standard të lartë profesional. Me lokacione moderne në Prishtinë, Istog dhe Deçan, kjo poliklinikë është sinonim i cilësisë, inovacionit dhe trajtimit të personalizuar për çdo pacient.

## Stomatologji & Implantologji

*Në Poliklinikën Shoshi ofrohen të gjitha shërbimet e stomatologjisë duke përfshirë:*

**Implantologji** me teknologji të avancuar, ku përdorimi i implanteve me ngarkim të menjëhershëm bën të mundur vendosjen e dhëmbëve brenda një kohe shumë të shkurtër, pa nevojë për pritje të gjata. Ky proces është efikas, i sigurt dhe me çmime të volitshme, duke ofruar rikthim të menjëhershëm në funksion dhe estetikë.

**Estetikë dentare** për buzëqeshje natyrale

**Ortodonci** me aparat fiks, të lëvizshëm dhe aparate ortodontike transparente (aligners) për një përvojë efikase drejt një shtrirjeje perfekte të dhëmbëve



## Kirurgji maksillofaciale & plastike

*Një tjetër shtyllë e fortë e Poliklinikës Shoshi është kirurgjia maksillofaciale, që përfshin:*

**Kirurgji të nofullave** për probleme funksionale apo estetike

**Rinoplastikë** (kirurgji e hundës) dhe otoplastikë (kirurgji e veshëve)

**Trajtimin e anomalive** të lindura me qasje multidisciplinare dhe teknologji të fundit



## Oftalmologji e avancuar dhe Okuloplastikë

*Nga diagnostikimi tek ndërhyrjet kirurgjikale*

*Poliklinika Shoshi ofron të gjitha shërbimet e specializuara në oftalmologji:*

**Blefaroplastika**, apo kirurgjia e kapakëve-një ndërhyrje e sigurt dhe minimale që eliminon lëkurën e tepërt dhe fryrjet rreth syve, duke ju dhënë një pamje më të re dhe më të freskët.

**Kirurgji me laser** për kataraktën (perden e syrit).

**Intervenim kirurgjik** për glaukomën (tensionin e syrit).

**Kirurgji për strabizmin** (sytë e kryqëzuar).

**Kirurgji e kanaleve të lotit.**

**Diagnostikim me OCT, Angio-OCT, ultrazë** - të rastet me diabet, hipertension dhe sëmundje të tjera sistemike.

**Shërbime optike** me përcaktim digjital të dioptrisë dhe syze nga markat më të njohura botërore.



# POLIKLINIKA SHOSHI

## **Dermatologji & Estetikë me teknologji të gjeneratës së re.**

*Në klinikën tonë, ofrojmë një gamë të plotë trajtimesh të personalizuar që kombinojnë teknologjinë më të avancuar me kujdesin dermatologjik profesional si dhe me lasera të gjeneratës së fundit, të personalizuar sipas nevojave të secilit pacient.*

Fillers & Botox – Përdoren për të rimodeluar tiparet, reduktuar rrudhat dhe rikthyer volumet natyrale të fytyrës, gjithmonë me rezultate të balancuara dhe harmonike.

## **Trajtime inovative për pastrim të thellë të fytyres, hidratim dhe rigjenerim të lëkurës.**

*Laseri PicoSure® Pro ofron rezultate të dukshme, është shumë efektive në largim të hiperpigmentimeve, kapilarëve edhe për tatuazhe me ngjyra të vështira (jeshile, blu, e kuqe).*

Të parët të paisur me laser me një sistem inteligjent, i përshtatshëm për heqjen e qimeve (maksimumi 6-8 seanca), njolla, kapilarë të zgjeruar, dhe tonifikim të përgjithshëm të lëkurës.

**Teknologjia e fundit e CO2 Laser** – Ideal për trajtime më të thella: rigjeneron lëkurën, zbut rrudhat, përmirëson cicatricet (shenjat nga aknet, djegiet ose ndërhyrjet kirurgjikale) dhe jep efekt “lifting” pa ndërhyrje kirurgjikale.

## **Trajtim pa dhimbje me sedacion Baldus**

Poliklinika Shoshi është pionier në trajtimin e pacientëve me frikë apo ankth nga ndërhyrjet mjekësore, duke përdorur sedacionin koshient nga Baldus Sedation – teknologji gjermane, që siguron një përvojë të qetë dhe pa dhimbje.

# **POLIKLINIKA SHOSHI - QENDRA KU SHËNDETI DHE KUJDESI TAKOHEN**

Për çdo nevojë shëndetësore – nga një konsultë e thjeshtë te trajtimet më komplekse Poliklinika Shoshi është zgjedhja e parë e mijëra pacientëve në vend dhe diasporë.

**Na gjeni në Prishtinë, Istog dhe Deçan.  
Ku përkushtimi ndaj pacientit nuk ka kompromis!**

Poliklinika Shoshi - Prishtinë **+383 48 124 298**

Poliklinika Shoshi & Optika Ylli - Istog **+383 45 292 112**

Optika Shoshi - Deçan **+383 45 866 666**

@poliklinikashoshi.optikaylli  
poliklinikashoshi.com

# VJESHTA E FESTIVALEVE TË KËNGËVE NË KOSOVË

Në Kosovë, vjeshta nuk është thjesht stinë e gjetheve që bien apo ditëve që ftohen. Është stinë e muzikës dhe festivaleve, kur qytetet mbushen me zëra, tinguj e ritme që i japin kësaj periudhe një gjallëri të veçantë. Nga Prishtina te Peja, e deri në Gjakovë, kalendari i tetorit është një ftesë për të përjetuar artin në forma të ndryshme.



## **Prishtina International Vocal Festival (17–23 tetor, Prishtinë)**

Kryeqyteti e hap sezonin me një festival të dedikuar fuqisë së zërit njerëzor. Për shtatë ditë rresht, këngëtarë nga Kosova dhe nga vende të ndryshme të botës sjellin koncerte që e kthejnë Prishtinën në një skenë ndërkombëtare. Për vizitorët, është një rast i rrallë për të parë se si një qytet i vogël ngrihet në nivelin e metropoleve të mëdha kulturore.

## **Peja Jazz Festival (23–26 tetor, Pejë)**

Në fund të muajit, Peja ndizet me tingujt e jazz-it. Muzikantë vendorë dhe ndërkombëtarë e mbushin qytetin me improvizime, ritme e harmoni që zgjasin deri natën vonë. Festivali shpesh kombinohet me një shëtitje në Grykën e Rugovës, ku ajri i freskët dhe peizazhi malor ofrojnë kontrastin ideal pas një mbrëmjeje me muzikë. Dhe pse jo, një pjatë ushqimi tradicional pejan është pjesë e përvojës.



## **ReMusica – International Music Festival (27–30 tetor, Prishtinë)**

Fundvjeshta në Prishtinë sjell edhe një tjetër ngjarje unike: ReMusica, festival i muzikës moderne dhe eksperimentale. Ky është vendi ku dëgjon diçka ndryshe, jashtë kornizave të zakonshme. Koncertet shpesh ndërthuren me atmosferën urbane të kryeqytetit, ku arti dhe jeta e përditshme bashkëjetojnë natyrshëm - në kafenetë, sheshet dhe galeritë e qytetit. Në Kosovë, vjeshta është një kalendar i gjallë ngjarjesh. Nuk është vetëm për të parë gjethet që ndryshojnë ngjyrë, por për të dëgjuar se si një vend i vogël i Ballkanit këndon me zë të madh.

# 25 VENDET MË TË MIRA PËR TË UDHËTUAR NË VITIN 2025

Nga të dhënat e reporterëve të vet dhe të dhënat e organizatave kryesore botëror të turizmit, BBC ka publikuar listën me vendet më të veçanta për t'u vizituar gjatë vitit 2025. Pamjet përrallore dhe përvojat që do të krijohen gjatë këtyre vizitave do t'ju mbesin në kujtesë gjatë gjithë jetës.

## 1. Dominika



Në krye të renditjes për vizitë është Dominika, ishulli në Karaibe, i cili është edhe rezervati i parë i balenave sperme. Lejet e kufizuara për not pranë balenave sigurojnë takime të

afërta e respektuese, duke u ofruar vizitorëve një përvojë të paharrueshme, ndërkohë që ndihmojnë kërkimet shkencore dhe krijojnë mundësi turizmi të qëndrueshëm për banorët lokalë. BBC shkruan se zona arrihet lehtë e aeroplan, ndërsa në ishull janë ndërtuar hotele të reja, përfshirë "Hilton Tranquility Beach Resort and Spa" me gjashtë yje në Salisbury. Ose mund të zgjedhësh një klasike të provuar, si Secret Bay, një resort luksoz ekologjik. Përveç kësaj, vizitorët mund të eksplorojnë kanione të fshehura, ujëvara madhështore dhe të shijojnë kuzhinën vendase në restorante unike, si Lacou me konceptin "nga ferma në tryezë".

## 2. Naoshima, Japoni



Ishulli japonez Naoshima, që strehon një nga skulpturat ikonike të kungullit të verdhë me pika të zeza të Yayoi Kusama-s, është shndërruar në një destinacion të domosdoshëm

për adhuruesit e artit bashkëkohor dhe arkitekturës. Me një program prej më shumë se 100 ditësh, i ndarë mes pranverës, verës dhe vjeshtës, për t'u dhënë mundësi vizitorëve të shijojnë rajonin në stinë të ndryshme.

## 3. Dolomitet, Itali



Në listën e BBC për t'u vizituar rekomandohen Dolomitet në Itali. Malet ku janë planifikuar të mbahen lojërat olimpike 2026 rekomandohen për vizitë, për pamjet e

tyre bresëlënëse. "Mbretëresha e Dolomiteve", Cortina d'Ampezzo, është planifikuar të presë Lojërat Olimpike.

Dimërore 2026. Dolomitet janë një destinacion emocionues në çdo stinë, në pranverë, verë apo vjeshtë, për të shijuar shtigje të shkëlqyera, si Cammino Retico (Rruga Retike), e hapur në vitin 2024; një shteg 170 km, shtatëditor, që lidh fshatra të largëta mes rajoneve Veneto dhe Trentino.

## 4. Grenlanda



Nuk ka vend në Tokë si Grenlanda. Me një sipërfaqe mbi dy milionë km<sup>2</sup>, ishulli më i madh në botë ka një popullsi prej më pak se 57,000 banorësh. I mbuluar nga

një shtresë gjigante akulli dhe male madhështore, natyra e tij e paprekur dhe fjordet mahnitëse nuk janë vetëm një entitet i lakmuar gjeopolitik; ato ofrojnë aventura të një jete. Ecjet e mrekullueshme dhe vrojtimi magjepsës i balenave në verë, qentë e slitave tradicionale dhe aurora magjike në dimër e bëjnë Grenlandën një destinacion ëndrrash.

## 5. Uells



Uells është plot me parqe kombëtare mahnitëse, kështjella mesjetare frymëzuese dhe me pak turma – gjë që vetëm sa ia shton hijeshinë. Në vitet e fundit, Uells është pozicionuar në pararojë të udhëtimeve të qëndrueshme dhe të fokusuara te kultura. Turizmi

ka ndihmuar në ringjalljen e gjuhës uellsiane dhe vendi është në mes të një programi shumëvjeçar prej 5 miliardë funte sterling, që përdor fondet e turizmit për ta bërë më të qëndrueshme mjedisin në destinacione të ndryshme.

## 6. Newfoundland Perëndimore dhe Labrador, Kanada



Labradori, pjesa kontinentale e Newfoundland dhe Labrador në lindje të Kanadasë, është një rajon i gjerë dhe i ashpër, i njohur për fshatrat bregdetare të ekspozuara ndaj erës, ajsbergët gjigantë, pyjet subarktike dhe ujëvarat masive - të gjitha të

mbështetura nga më shumë se 9,000 vjet histori njerëzore. Në vitin 2025, përfundimi i fazës së fundit të autostradës Trans-Labrador 1,200 km – një arritje që mori gati 25 vjet dhe kushtoi 1 miliard dollarë - e shndërron këtë peizazh të largët prej 294,330 km<sup>2</sup> në një destinacion më të arritshëm.

## 7. Tucson, Arizona - ShBA



Dikur pjesë e Meksikës, zona që sot quhet Tucson, ofron një peizazh të bukur për adhuruesit e shtigjeve shkretinore dhe ndërtesat historike të qytetit, si San Xavier del Bac, një kishë 250-vjeçare e njohur si "Pëllumbi i Bardhë i Shkretëtirës".

Ruajtja e tillë është një arsye pse qyteti këtë vit do të marrë një Çmim të Indeksit të Qëndrueshmërisë nga Global Destination Sustainability Movement (GDS). Por, përtej ndërtesave historike, kopshtet përreth zbulojnë një histori edhe më të pasur: ato janë tokat më të vjetra të kultivuara vazhdimisht në ShBA.

## 8. Australia Perëndimore



E njohur si qyteti i madh më i izoluar në botë, Perth dhe shteti i Australisë Perëndimore kanë një peizazh gjigant që shtrihet në më shumë se 2.5 milionë km<sup>2</sup>, duke përfshirë 12,500 km vijë bregdetare të pacenuar, liqene rozë si

çamçakëz, ujëvara horizontale, pyje gjigante, lule të egra, kantina vere dhe përvoja unike me botën e egër si noti me peshkacenë, balenë, apo fotot me quokka, "kafsha më e lumtur në botë". Për aventurierët e vetëdijshëm për mjedisin, është hapur një Autostradë Elektrike 6,600 km, rrjeti më i gjatë i karikimit për makina elektrike në botë.

## 9. Sri Lanka



Nga plantacionet me çaj në majat me mjegull dhe elefantët e egër endacakë, te tempujt e lashtë dhe dallgët e pafundme për surf, Sri Lanka është një vend që i plotëson të gjitha dëshirat. Ky shtet ishullor i qëndrueshëm shpreson të ngrihet sërish

përmes turizmit. Qyteti i Kandy do të ketë hotelin e tij të parë me shtatë yje, Aviyana Private Chalets, ndërsa Aarunya Nature Resort ka hapur një vilë të re familjare që përfshin një oculus për shikimin e yjeve.

## 10. Panama



Panama është një përvojë e paharruar në mes xhunglave të pafundme, ishujve idilikë dhe pyjeve malore përtej kanalit. Në vitin 2024, harta Meaningful Travel Map to Panama u lansua në partneritet me organizatën jofitimprurëse Tourism Cares,

për t'ua bërë më të lehtë vizitorëve gjetjen e përvojave të udhëhequra nga vendasit. Pas një turri ecjeje, Localinpty në lagjet Casco Antiguo dhe El Chorrillo në Panama City, shkoni në jugperëndim drejt rajonit La Pintada, ku artizanët endin fibra për të bërë kapelat tradicionale panameze - një praktikë e njohur nga UNESCO si Sombrero Pintao.

## 11. Malet Rif, Marok



Malet e mbuluara me dëborë, shkretëtirat e gjera, qytetet e lashta dhe trashëgimia e pasur kulturore, e kanë bërë prej kohësh Marokun një nga destinacionet më të njohura në Afrikën e Veriut. Por, tërmeti i Al Haouz në shtator 2023 jo vetëm që shkatërroi

pjesë të Marrakeshit dhe maleve Atlas, por ndikoi rëndë edhe tek turizmi. Teksa Maroku vazhdon të ndërtojë (dhe rindërtojë) infrastrukturën turistike në përgatitje për bashkë-organizimin e Kupës së Botës FIFA 2030, vendi synon të dyfishojë numrin e turistëve në pesë vitet e ardhshme.

## 12. Bradford, Angli



Qyteti verior anglez Bradford më në fund është gati të dalë nga hija e gjatë e fqinjit të tij të madh, Leeds, duke marrë

titullin e Qytetit të Kulturës së Mbretërisë së Bashkuar për vitin 2025. Një program fantastik njëvjeçar aktivitetesh përfshin rihapjen e Muzeut Kombëtar të Shkencës dhe Medias, si dhe kretime inovative të ikonave kulturore vendase: mbi 400 vepra të artistit të lindur në Bradford, David Hockney, të vendosura në një fabrikë të vitit 1850, të shpallur Trashëgimi Botëror nga UNESCO; interpretimet digjitale të botës imagjinare të krijuar nga motrat e famshme shkrimtare Brontë; dhe një program muzikor që përzien simfoni elektronike, muzikë popullore të fabrikave të vjetra, banda bronzi dhe tinguj të Azisë Jugore.

## 13. Jordania



Shtëpia e disa prej peizazheve më mahnitëse shkretinore në botë dhe kryeqyteti i lashtë i një prej civilizimeve më misterioze të historisë, Jordania gjithmonë zgjon habi. Por, nëse shikon nga afër, vendi ka ndërtuar me

qetësi reputacionin si destinacioni kryesor i Lindjes së Mesme për aventurierët e natyrës. Në vitin 2023 u hap një shteg i ri 10-ditor, 120 km i gjatë, i quajtur Wadi Rum Trail, i cili përshkon shkëmbinj të kuq të shkretëtirës ikonike Wadi Rum, të shfaqur në filma si Star Wars, Dune dhe The Martian. Ky projekt i turizmit komunitar nxit një formë më të ngadaltë e të qëndrueshme udhëtimi që mbron ekosistemin delikat të shkretëtirës dhe trashëgiminë kulturore të beduinëve vendas.

## 14. Lugina Haa, Butan



E izoluar për shekuj, Butani hapi kufijtë për vizitorë vetëm në vitin 1974 dhe sot është udhëheqës global në qëndrueshmëri: është vendi i parë karbon-negativ në botë, mbi 60% e tokës së tij është pyll i mbrojtur dhe zhvillimi matet me

Lumturinë Kombëtare Bruto në vend të PBB- së. Lugina Haa, në kufirin perëndimor me Tibetin, ka mbetur sekret i më i ruajtur i Butanit – një rajon kulturor unik, i paprekur nga turizmi masiv. Vetëm 2% e vizitorëve ndërkombëtarë shkojnë aty, edhe pse është afër aeroportit të Paros. Ajo po hapet ngadalë me kujdes për të balancuar ruajtjen dhe zhvillimin.

## 15. Hawaii, SHBA



Pas zjarreve shkatërruese në Maui, në vitin 2023, turizmi ka rënë ndjeshëm. Por komunitetet vendase po rindërtojnë dhe ftojnë vizitorët të kthehen, mirëpo me përgjegjësi. Programi Mālama Hawaii (që do të thotë “të mbrosh” ose “të

kujdesesh”) u jep udhëtarëve mundësinë të marrin pjesë në mbi 350 aktivitete vullnetare: nga mbjellja e pyjeve vendase të gatimi me familje lokale, deri të mbrojtja e habitateve të faunës. Në këmbim, vizitorët përfitojnë ulje çmimesh apo qëndrime falas në shumë resorë, përfshirë Four Seasons Resort Maui dhe Wailea. – Eliot Stein.

## 16. Uzbekistani



Me mbi 60% të popullsisë nën 30 vjeç, Uzbekistani është plot energji rinore. Kryeqyteti Tashkent, me metrotë e tij të dekoruara me mozaikë sovjetikë, është simbol i këtij transformimi. Në shtator 2025 mbahet Bienalja e parë

ndërkombëtare në Bukhara. Projekte të tjera përfshijnë zgjerimin e Muzeut Shtetëror të Arteve nga Tadao Ando dhe restaurimin e Pallatit të Princit Romanov.

## 17. Haida Gwaii, Kanada



Ky arkipelag me mbi 150 ishuj në brigjet e British Columbia është i njohur për biodiversitetin unik dhe kulturën e lashtë të popullit Haida, që jeton aty prej më shumë se 15,000 vjetësh. Në vitin 2025 hyn në fuqi marrëveshja Gaayhlxid/

Giilhalgalgang “Rising Tide”, e cila njeh Këshillin e Kombit Haida si autoritetin ligjor të territorit - një moment historik për të drejtat indigjene.

## 18. Bregu i Smaragdit, Nikaragua



Nikaragua, vend me pyje tropikale, vullkane madhështore dhe qytetin historik Granada (500 vjetor më 2024), po bëhet më i aksesueshëm falë autostradës së re Carretera Costanera (350 km). Ajo lidh 53 plazhe të Paqësorit

dhe do të përfundojë në vitin 2025. Kjo rrugë e re do të ndihmojë ekonominë vendase dhe do të lehtësojë udhëtimin drejt destinacioneve si San Juan del Sur e Popoyo, të njohura për surf. Në jug, në Refugio de Vida Silvestre La Flor, vizitorët mund të shohin mijëra breshka të rrezikuara duke hedhur vezët – një eksperiencë e paharrueshme. – Eliot Stein

## 19. Isle of Man



I njohur për vendbanime të lashta si Cashtal yn Ard dhe Castle Rushen, ishulli është gjithashtu një rezervat Biosferik UNESCO që nga viti 2016. Në vitin 2024 u hap

Manx Birdlife Point of Ayre National Reserve, ndërsa në 2025 festohet 175-vjetori i birrarisë Okell's Brewery. Një mënyrë e shkëlqyer për të zbuluar ishullin është në këmbë: shtigjet ofrojnë pamje që përziejnë fushat angleze, kodrat irlandeze, brigjet uellsiane dhe malet skoceze. Nga maja e Snaefell, në një ditë të kthjellët, mund të shohësh të gjitha vendet e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës. - Lynn Brown 20. Rajoni Gilgit-Baltistan, Pakistan Ky rajon verior është shtëpia e pesë majave mbi 8,000 m, përfshirë K2. Iniciativat e reja të turizmit të qëndrueshëm po e shndërrojnë Pakistanin në një destinacion për alpinistë dhe aventurierë. Përmes platformës Salam Pakistan, vizitorët mund të aplikojnë lehtësisht për viza trekkingu. Por përveç maleve, Gilgit-Baltistan ofron lugina me qershi në lule, fusha të UNESCO-s si Deosai Plains, liqene të pasqyruar dhe Khunjerab Pass, i cili do të jetë i hapur gjatë gjithë vitit nga 2025. - Aysha Imtiaz

## 21. Azoret, Portugali



Ky arkipelag prej nëntë ishujsh në Oqeanin Atlantik është i njohur për plazhet me rërë të zezë, burimet termale dhe mundësitë e shikimit të balenave. Në

tetor të vitit 2024, Azoret shpallën zonën më të madhe të mbrojtur detare në Evropë (287,000 km<sup>2</sup>), duke ruajtur koralet, peshkaqenët dhe 28 specie balenash e delfinësh. Vizitorët mund të shijojnë Luginën Furnas me vullkanet aktive, kopshtet botanike dhe parkun Terra Nostra. Në 2025, hoteli historik Terra Nostra Garden Hotel do të ofrojë pishina termale të përmirësuara 24-orëshe. Mos ikni pa provuar cozido das furnas, një gjellë që gatuhet nën tokë me nxehtësinë e burimeve gjeotermale. - Michelle Gross

## 22. Kansas City, Missouri - ShBA



Në vitin 2025, Kansas City po ribëhet si një destinacion kulturor kryesor. Kryefjala është Muzeu i BBQ-së, i pari në botë kushtuar artit të

mishit të tymosur, që u hap në pranverë të vitit 2025. Qyteti po investon në zhvillimin urban, me zona të reja argëtimi si Rock Island Bridge, që u hap në pranverë të vitit 2025 mbi lumë. Aeroporti ndërkombëtar i rinovuar dhe zgjerimi i tramvajit do ta bëjnë qytetin edhe më të aksesueshëm. - Eva Sandoval

## 23. Bolivia



Në gusht të vitit 2025 Bolivia festoi 200-vjetorin e pavarësisë me aktivitete në të gjitha rajonet. Në Carnaval de Oruro (shkurt-mars) do të ketë parada shumëditore të shpallura

Trashëgimi Botërore nga UNESCO. Në Potosí, vizitorët mund të provojnë pijen tradicionale singani. Ndërsa në Sucre, qyteti ku u shpall pavarësia, ndodhet Muzeu i Artit Indigjen me tekstile të lashta. Turizmi komunitar po zhvillohet gjithashtu në zona si Chalalan Ecolodge në Parkun Kombëtar Madidi, ku mund të shihen kapibara, jaguarë dhe arinj me syze. - Laura Norkin

## 24. Botswana



E njohur si "Kryeqyteti Botëror i Elefantëve", Botswana është udhëheqëse në turizmin e gjelbër të safarit. Delta Okavango dhe

Parku Kombëtar Chobe janë ndër atraksionet kryesore. Në vitin u 2025 hapën lodgje të reja luksoze si Mbamba Camp (prill) dhe Monachira Camp (maj). Po ashtu, linjat e reja të Air Botswana do të lidhen me Cape Town, duke e bërë më të lehtë eksplorimin e natyrës së mahnitshme të vendit. - Eva Sandoval

## 25. Oslo, Norvegji



Një qytet i gjelbër, i njohur për arkitekturën moderne dhe aksesin e lehtë te fjordet e natyra. Fushata e re turistike pyet me humor: "A është vërtet një qytet?" Oslo është

një nga qytetet më të qëndrueshme në botë: hotelet kanë çati të gjelbra, qyteti është përshtatshëm për ecje dhe i pasur me pyje. Vizitorët mund të ndjekin Green Oslo Guide dhe të përfetojnë aktivitete si kajak në fjordet akullnajore apo ndjekje e Dritave të Veriut me Norwegian Adventure Company. Pas eksplorimit, mund të shijoni ushqim lokal organik në restorante si Maaemo me yll Michelin. - Lynn Brown



# BISHTI I LEPURUSHIT

## Si e humbi lepuri bishtin?

Dikur lepujt kishin bisht të gjatë.

Një ditë, një lepur po bridhte rrugës, ku u takua me dhelpërën, e cila kishte në gojë një tufë me peshq.

– Si arrite t'i kapësh gjithë këta peshq? – e pyeti lepur.

– Zbrit te rrëkeja, zhyte bishtin në ujë dhe prit atje tërë natën. Në mëngjes, në të gjitha qimet e bishtit tënd do të kesh sasi të mëdha me peshq. Nuk do të të mbetet tjetër veçse të zgjedhësh më të mirët.

Atë natë lepur shkoi të peshkonte te rrëkeja. Frynte erë, bënte ftohtë. Lepuri dridhej; nganjëherë fërkonte putrat e vogla njërën pas tjetrës. Nisi dëbora, flokët e saj të bardhë binin mbi turirin e lepurit të gjorë.

Kur agoi, lepur ende gjendej te rrëkeja. Atëherë mendoi e tha me vete: “Tani erdhi koha!”. E tërhoqi bishtin për të kapur peshqit, por rrëkeja ishte ngrirë gjatë natës; akulli e mbërtheu fort bishtin e lepurit të gjorë, ndaj nuk mundi të ikte dot. Atëherë e tërhoqi aq fort bishtin e vet të gjatë, sa iu këput në rreke. Që prej asaj dite lepujt e kanë bishtin kaq të shkurtër.





# BRETKOSA E ZGJUAR

Nga të gjitha bretkosat që jetonin në pellgun në pyll, Tomi ishte më i zgjuari.

Ai mund të fliste për orë të tëra për yjet në qiell, për mënyrën se si rriteshin bimët ose për jetën e poetëve dhe mbretërve të mëdhenj.

Ai kishte gjithashtu një fjalor shumë të madh! "Tomi dinte kaq shumë fjalë të bukura sa ndonjëherë nuk mund ta kuptojë se çfarë do të thotë!", tha fqinji i tij. "Kaq shumë i zgjuar është!"

Tomi ishte një bretkosë shumë miqësore dhe e sjellshme, por ai ishte, gjithashtu, krenar që ishte më i zgjuari në pellg.

Kjo ishte arsyeja pse ai kurrë nuk kërkoi këshillën e askujt dhe nuk u interesua për mendimet e tyre! Një ditë, ai vendosi të shkonte në pyll për të lexuar.

"Dua të përfundoj librin tim dhe është e vështirë të përqendrohem këtu për shkak të të gjitha kërcitjeve!", tha me vete. Kështu, ai hipi në pyll dhe gjeti një karrige të bukur për të lexuar.

Megjithatë, pasi lexoi për disa orë, Tomi u ndje i shqetësuar. "Unë

mund të shëtis përreth për pak!", tha ai. "Do të marr rrugën e gjatë për në pellg kush e di se çfarë do të gjej gjatë rrugës."

Ai u largua nga shtegu i pyllit, por nuk kaloi shumë kohë dhe ai kishte humbur rrugën. "A e kam kaluar më parë atë pemë?", mendoi ai. "Isha i sigurt se pellgu im ishte këtu!" Pikërisht atëherë, një urith nxori kokën nga toka.

"Oh, përshëndetje Tomi!", tha urithi. "Ju jeni shumë larg nga pellgu, keni nevojë për udhëzime?"

Tomi nuk donte që askush të mendonte se dikush aq i zgjuar sa ai do të kishte nevojë për ndihmë.

"Oh jo, jam mirë!", i tha urithit para se të largohej me nxitim. Tashmë ishte bërë shumë errësirë. A do të ishte në gjendje Tomi të kthehej në shtëpi para se të bjerë nata?

Ai dëgjoi një britmë të fortë. Ishte një zhabë e vjetër, e cila po e vështronte. "Çfarë bën një bretkosë e vogël si ti në pyll në këtë kohë të natës? Dëshironi udhëzime?", tha zhaba.

Por Tomi ende ndihej shumë krenar dhe i turpëruar për të

pranuar se kishte humbur.

"Oh jo, unë jam ... duke parë yjet!", mërmëriti ndërsa po largohej me nxitim.

"Si mund t'i shikosh yjet në një pyll me kaq shumë pemë?", u habit zhaba. "Çfarë bretkose budallaqe!"

Tani ishte vërtet errësirë dhe Tomi kishte humbur të gjithë ndjenjën e orientimit. Në errësirë, nuk mund të shihte asnjë pikë referimi për ta udhëhequr.

"Si do të jem në gjendje të gjej rrugën time për në shtëpi tani?", mendoi me vete duke u ndjerë i mjerë. Ai do të donte që të mos ishte aq krenar për zgjuarsinë e tij dhe në vend të kësaj të kishte kërkuar ndihmë. "Ndoshta dikush do të vijë dhe do të më ndihmojë?", bërtiti ai me shpresë.

Por pylli ishte i errët dhe i heshtur. Asnjë kafshë e vetme nuk erdhi dhe bretkosa e zgjuar duhej të kalonte një natë të lagësht dhe të ftohtë duke u dridhur nën një kërpudhë. Tomi vendosi që, tani e tutje, ai nuk do të ishte shumë krenar për të kërkuar këshilla. "Nëse do të isha vërtet i zgjuar, do t'i kisha dëgjuar të tjerët!", mendoi ai.

# WTF?! ANIMACIONI SËRISH PUSHTOI PEJËN

## Gentiana Ahmeti

Çdo vit, mes maleve të Rugovës dhe lumit Lumbardh, qyteti i Pejës në perëndim të Kosovës shpërthen në ngjyra. Këtë vit, nga 14 deri më 20 korrik 2025, Peja mirëpriti sërish Festivalin e Animacionit Anibar, i vetmi festival animacioni në Kosovë dhe, pas gjashtëmbëdhjetë edicionesh, një nga ngjarjet kulturore më guximtare në Ballkan.

Tema e këtij edicioni ishte një lojë fjalësh dhe një sfidë

njëkohësisht: “WTF?! What’s the Future?!”(Çfarë sjell e ardhmja?). Nuk ishte vërtet një temë, por një ftesë për të përqafuar pasigurinë.

Megjithëse shirat e verës përshkuan qytetin dhe sollën disa vonesa veçanërisht për kinemanë e hapur programi nuk humbi asnjëherë gjallërinë. Sallat e Pejës u mbushën me krijues filmash dhe spektatorë që ndoqën veprat konkurruese në shtatë kategori:

Ndërkombëtare, Ballkanike,

Studentore, Programi “Pitch It!”, të Drejtat e Njeriut, Videoklipe të Animuar Muzikore dhe Audiencia e Re. Në ditën e fundit u shpallën fituesit, por fitorja e vërtetë ishte shkëmbimi i ideve dhe frymëzimi që la gjurmë në mbarë qytetin.

Çdo mëngjes, regjisorë e animatorë nga vende të ndryshme ndanë rrëfimet duke pirë kafën e mëngjesit, duke kthyer një ritual të thjeshtë në një hapësirë të thellë lidhjeje.



FOTO ELMEDINA ARAPI



Më vonë, diskutimet e hapura me publikun sollën reflektime mbi çështje që na prekin çdo ditë dhe nxitën pyetje të guximshme mbi të ardhmen. Një nga bisedat ishte paneli “Si të nisësh (dhe të mbash gjallë) karrierën e animacionit në Ballkan”, i moderuar nga regjisorja dhe producentja e njohur ndërkombëtarisht, Vessela Dantcheva. Zëra nga Kosova, Kroacia, Maqedonia e Veriut e më gjerë folën për këmbënguljen, shkathtësinë lokale dhe fuqinë e rrjeteve joformale në ruajtjen e gjallë të krijimtarisë në një rajon ku mbështetja për artin hpush mungon. “Ne filluam me animacione të vogla,” kujtoi

“

**Për shtatë ditë me radhë, Peja u shndërrua në një hapësirë të gjallë. Për vizitorët, Anibar ofroi më shumë sesa filma. Ata zbuluan një qytet që i priti me krahë hapur, ku mund të shëtisnin në Grykën e Rugovës gjatë ditës, të pinin një gotë raki me një animator nga Tokio në mbrëmje dhe të shihnin filma avangardë të projektuar mbi muret shekullore të qytetit natën.**

Dantcheva. “Dhe ja ku jemi sot.” Për ata që ishin aty, edicioni i gjashtëmbëdhjetë i Anibarit ishte më shumë sesa një festival. Ishte

një kujtesë se edhe në kohë të pasigurta, krijimtaria gjithmonë gjen rrugë jo vetëm për të mbijetuar, por për të lulëzuar.

# SERAFINI RESTAURANT

## A FIRST-CLASS TASTE OF PRISTINA



**N**ë zemër të Prishtinës, Serafini Restaurant ju mirëpret për një eksperiencë unike kulinare, ku eleganca takohet me shijen e rafinuar. Me një ambient modern dhe mikpritës, ky restorant është destinacioni ideal për dashamirët e ushqimit që kërkojnë diçka më shumë se një darkë – kërkojnë një përjetim. Shefat tanë krijojnë pjata të frymëzuara nga kuzhina italiane dhe mesdhetare,

duke përdorur përbërës të freskët dhe teknika bashkëkohore. Që nga sallatat e pasura me shije, pastat e përgatitura me mjeshtëri, e deri te verërat e zgjedhura me kujdes, çdo detaj është menduar për të kënaqur shqisat tuaja. Me një atmosferë intime dhe një shërbim të nivelit të parë, Serafini është vendi i përsosur për një darkë romantike, takime biznesi apo momente të veçanta me miqtë dhe familjen.



📍 Adresa: Rr. Dr. Shpëtim Robaj, Prishtinë  
Orari: E martë – E diel, nga **14:00 deri në 23:00 (të hënave mbyllur)**

📱 Na gjeni në Instagram: [\[@serafinirestaurant\]](#)

*Serafini Restaurant*  
*ku shija bëhet art.*



Për shëndet të mirë!

## Shërbimet:

- Laboratori i biokimisë dhe hematologjisë
- Laboratori i mikrobiologjisë
- Mjekësi familjare
- Pediatri
- Nefrologji
- Psikologji
- Kardiologji
- Endokrinologji
- Pulmologji
- Ortopedi
- Urologji
- Radiologji (perfshirë CT, radiografi)
- Kirurgji e përgjithshme

**Prishtinë**  
**Prizren**  
**Suharekë**  
**Gjilan**  
**Mitrovicë**  
**Ferizaj**

|                         |                  |
|-------------------------|------------------|
| Qendra Tregtare Dardha  | +383 48 32 31 30 |
| Rr. Wesley Clark,       | +383 48 52 00 08 |
| Rr. Skënderbeu          | +383 48 52 00 04 |
| Rr. 7 shtatori          | +383 49 52 01 25 |
| Rr. Minatorët e Trepçës | +383 48 52 00 05 |
| Rr. Uran Tinova         | +383 48 52 05 25 |

**Olive Clinic** kujdeset për shëndetin tuaj!



GROUP  
**Blendi**

**shpejt,  
lirë dhe  
kualitet**

SHTYPSHKRONJË | REKLAMA & 3D | MATERIAL ZYRTAR  
MATERIAL SHKOLLOR | RAFTA METALIK | KARRIGE PËR ZYRE

 [www.blendi-ks.com](http://www.blendi-ks.com)

  [blendigroup](https://www.facebook.com/blendigroup)



KATALOGU  
MAKINERIVE



KATALOGU  
PROMOCIONAL



**BLUETAXI**  
044 800 900  
049

**BLUE TAXI  
PO JU PRET**  
REHATI, SIGURI, KORREKTËSI





## USHQIMET ULTRA TË PËRPUNUARA, NË MESIN E SHKAKTARËVE TË KANCERIT

Termi ushqime ultra të përpunuara përdoret ne vitet e fundit për të emëruar ushqimet e konservuara, të cilat përmbajnë aditivë, ngjyrosës artificialë, aromatizues, ëmbëltues, konservues kundër mykut ose baktereve, apo shtesa që rrisin shijet e ushqimit të konservuara.

Këta përbërës gjenden lehtë në produkte si pijet e gazuara, patatina, supat e paketuara, filetot e pulës të skuqura apo ushqimet e tjera dhe, sipas një studimi të fundit, mund të rrisin rrezikun për kancer. Sipas një studimi të publikuar në revistën *Thorax*, njerëzit që konsumojnë më shumë ushqime ultra të përpunuara kanë 41% më shumë gjasa të diagnostikohen me kancer në mushkëri sesa ata që hanë më pak.

Për këtë studim, studiuesit analizuan të dhënat e më shumë se 100,000 personave që plotësuan pyetësin mbi frekuencën e ushqimeve të anketës kombëtare të shëndetit dhe ushqyerjes mbi zakonet e tyre ushqimore dhe i krahasuan ato me të dhënat mjekësore për diagnozat e kancerit të mushkërive.


Mesatarisht, njerëzit konsumonin pothuajse tre porcione në ditë ushqime ultra të përpunuara, më së shpeshti proshutë, pije dietale ose pije me kafeinë, ose pije jo me kafeinë, të gazuara, thonë autorët e studimit.

“Përpunimi industrial ndryshon strukturën e ushqimit, duke ndikuar në disponueshmërinë dhe përthithjen e lëndëve ushqyese, ndërkohë që gjeneron ndotës të dëmshëm”, shtuan studiuesit. Ata veçuan posaçërisht akroleinën, e cila mund të vijë nga djegia e duhanit, drurit, plastikës dhe benzinës, si dhe nga gatimi i yndyrave dhe vajrave në temperatura të larta, sipas Qendrave të ShBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve. Ata, gjithashtu, sugjeruan se materialet e paketimit mund të jenë pjesë e

problemit.

“Studimi është vëzhgues, që do të thotë se, megjithëse metodat ishin të qarta dhe të forta, hulumtimi nuk mund të provojë përfundimisht se ushqimet shkaktojnë kancer në mushkëri – vetëm se ka një lidhje mes të dyjave”, tha dr. David Katz, specialist i mjekësisë parandaluese dhe i stilit të jetesës dhe themelues i “True Health Initiative”. Ai nuk ishte i përfshirë në studim.

“Ky studim sugjeron fuqishëm që ushqimet ultra të përpunuara mund të kontribuojnë në rrezikun e kancerit në mushkëri”, tha ai.



## KANCERI I MUSHKËRIVE NUK LIDHET VETËM ME DUHANIN

Kanceri i mushkërive është një formë e zakonshme e kancerit, me rreth 2.4 milionë raste të reja në mbarë botën në vitin 2022, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

“Duhani është faktori kryesor i rrezikut, por edhe njerëzit që nuk pinë duhan mund të preken, gjë që sugjeron se janë të përfshirë edhe faktorë të tjerë”, tha Katz.

Autorët morën parasysh faktorë të tjerë që mund të ndikonin në diagnozën e kancerit të mushkërive, përfshirë nëse një person pinte duhan apo jo, por matjet nuk ishin të detajuara, tha dr. Fang Fang Zhang, nga Universiteti Tufts.

“Meqenëse pirja e duhanit është një faktor shumë i rëndësishëm për kancerin e mushkërive, një rregullim sipërfaqësor mund të lërë hapësirë për ngatërime të mbetura”, tha ajo. “Megjithatë, autorët gjetën se lidhja midis konsumit të ushqimeve ultra të përpunuara dhe rrezikut për kancer në mushkëri ishte më e fortë tek ata që nuk kishin pirë kurrë duhan.”



## ACIBADEM: URA E SHËNDETIT TUAJ MIDIS TURQISË DHE KOSOVËS

Acibadem është ofruesi kryesor i kujdesit shëndetësor në Turqi, duke ofruar për më shumë se 30 vjet një gamë gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar opsionesh trajtimi për të rritur dhe fëmijë të diagnostikuar me sëmundje të ndryshme.

Përveç 22 spitaleve të saj në Turqi, Acibadem ka edhe 6 spitale në 4 shtete të tjera: Holandë, Serbi, Bullgari dhe Maqedoni të Veriut. Grupi gjithashtu ka më shumë se 50 zyra "Health Point" në të gjithë botën. Këto zyra informacioni i ndihmojnë pacientët të kenë qasje në planet më të mira të mundshme të trajtimit dhe të koordinojnë të gjithë udhëtimin e tyre mjekësor në Turqi. Në Kosovë, Acibadem ka një zyrë informacioni të vendosur në Prishtinë.

Acibadem ofron shërbime shëndetësore në të gjitha specialitetet mjekësore, duke përfshirë onkologjinë, kardiologjinë, neurologjinë, gjinekologjinë, pediatrikë, ortopedinë dhe transplantimin e organeve dhe palcës së kockave.

Kujdesi Pediatric në Acibadem

# KY ËSHTË VENDI IM

**Bashkimi i kujdesit pediatric nën një çati**

- Alergologji Pediatric • Kirurgji Pediatric • Endokrinologji Pediatric
- Gastroenterologji Pediatric • Sëmundjet Gjenetike Pediatric
- Pneumologji Pediatric • Hematologji, Onkologji dhe Transplantimi i Qelizave Staminalë Pediatric • Transplantimi i Veshkave dhe Mëlçisë Pediatric
- Kardiologji Pediatric • Nefrologji Pediatric
- Neurologji Pediatric • Neurokirurgji Pediatric • Ortopedi Pediatric
- Urologji Pediatric • Shëndeti Mendor i Fëmijëve dhe Adoleshentëve

## Një qendër trajtimi për fëmijët me çrregullime neurologjike

Në Acibadem, një ekip i dedikuar për neurokirurgjinë pediatrike i udhëhequr nga Profesor Dr. Memet Özek, një specialist i shquar, përqendrohet ekskluzivisht në kujdesin e fëmijëve. Kjo është arsyeja pse Acibadem përbush një kërkesë të madhe të pacientëve në lidhje me neurokirurgjinë pediatrike në të gjithë botën. Çdo vit, Departamenti i Neurokirurgjisë Pediatricë pranë Acibadem operon me sukses 600 foshnje dhe fëmijë nga e gjithë bota.

Nga trajtimi i epilepsisë dhe menaxhimi i paralizës cerebrale deri te trajtimi i tumoreve të trurit dhe korrigjimi i keqformimeve kongjenitale, shërbimet tona mbulojnë të gjithë spektrin e neurokirurgjisë pediatricë. Ne gjithashtu ofrojmë fizioterapi të specializuar të projektuar posaçërisht për fëmijët me probleme neurologjike, e cila është një hap jetësor në shërim dhe i ndihmon pacientët e rinj të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme.

## Të sfidosh kufijtë në kirurgjinë pediatrike: Ndarja e binjakëve siamezë

Çdo pacient ka një histori unike. Kur pacienti është fëmijë, kjo histori shpesh mbart një kuptim edhe më të thellë. Dhe kur pacientët janë binjakë të lindur siamezë, historia bëhet vërtet e jashtëzakonshme. Binjakët siamezë janë një anomali kongjenitale e rrallë dhe komplekse që ndodh në rreth një në çdo 100,000 lindje të gjalla në të gjithë botën.

Fëmijë nga e gjithë bota me këtë anomali të rrallë janë referuar në Acibadem, ku operacionet e suksesshme të ndarjes u kanë dhënë atyre mundësinë të jetojnë jetë të shëndetshme dhe të pavarur. Elizabeth dhe Mary nga Kameruni ishin ndër këta fëmijë. Ato lindën të bashkuara në ijë, duke ndarë një pjesë të shtyllës kurrizore, si dhe traktin urinar, traktin tretës, sistemet urogjenitale dhe strukturat neuro-vaskulare.



Zbuloni historinë duke klikuar linkun



Në moshën nëntë muajshe, ato mbërritën në Turqi. Gjatë shtatë muajve të ardhshëm, me përfshirjen e mjekëve nga specialitete të shumta dhe një ekipi të madh profesionistësh të kujdesit shëndetësor, ato iu nënshtruan ekzaminimeve, përgatitjeve dhe operacioneve përgatitore të zgjeruara. Kirurgjia përfundimtare, që zgjati 27 orë, u pasua nga një proces gjithëpërfshirës post-operator. Sot, në moshën 5 vjeç, Elizabeth dhe Mary janë dy vajza të vogla fizikisht të pavarura dhe të lumtura.

Acibadem mirëpret pacientë nga e gjithë bota, duke ofruar kujdes profesional edhe për rastet më komplekse. Për informacion në lidhje me ngjarjet dhe konferencat e Acibadem në Kosovë, për t'u takuar me ekspertët tanë ose për të marrë një mendim mjekësor nga mjekët tanë, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Informacionit të Acibadem Kosova.

**+383 382 340 04**

**+383 495 634 00**

**kosovo@acibadem.com**

**www.acibadem.al**

**ACIBADEM**  
A CLASS HEALTHCARE SERVICES

# PRISHTINA

RENT A CAR

## Shijo Pushimet Tuaja

Me veturat e modeleve të fundit!



Skeno > Shkarko > Rezervo > Zbritje përfito



+38344240383



rentacar-prishtina.com

# SkyShop



# Shoqëruesi yt në çdo udhëtim

Në një botë ku gjithçka lëviz shpejt, ka pak gjëra që mbesin të njëjtat – si freskia natyrore e Miros. Ky ujë mineral natyral buron nga zemra e tokës së Kosovës, i filtruar në mënyrë të natyrshme përmes gurit kuarc, duke ruajtur një përbërje të pasur me kalcium, magnez dhe silikate.

S'ka rëndësi ku po shkon – rëndësi ka si ndihesh gjatë udhëtimit. Në aeroplan, mbi re, larg rutinës, Miros

është përkujdesja që merr me vete. Sepse nuk është thjesht ujë – është përzgjedhje. Është stil jetese. Është një mënyrë për të thënë “unë kujdesem për veten”.

Miros është për ata që përqendrohen në detajet që kanë vlerë – të natyrshme, të pastra, të vërteta. Në çdo gllënjë, ndjen pak nga toka jonë, pak nga kujdesi ynë, dhe shumë nga ajo që meriton ti.



# SkyShop Coffee&Tea



3 in 1 Nescafe Stick 20g  
2 in 1 Nescafe Stick 20g  
Nescafe Classic Stick 20g

2.50€

## LOYD

Cranberry Tea Bag  
Forest Fruit Tea Bag  
Camomile & Honey Tea Bag

2.50€



# SkyShop Soft Drinks

Coca Cola 0.33l  
Coca Cola ZERO 0.33l  
Fanta Orange 0.33l  
Fanta Exotic 0.33l  
Schweppes 0.33l  
Schweppes Tonic 0.33l  
Sprite 0.33l  
Multi Sola 0.5l  
Ice Tea 0.33l



**3.00€**



RC Cola 0.33l  
**2.50€**



Red Bull 250ml **4.00€**  
GO+ 250ml **2.50€**  
Veroni Isotonic **3.00€**

Malyrat Water Mirros 0.5l  
Sparkling Water Mirros 0.33l

**2.50€**

Capri Sun 0.33l

**3.00€**

Capri Sun 0.20l

**2.50€**

Jaffa 0.25l

**2.50€**



## SkyShop

# Alcoholic Beverages

Ballantines Finest 0.05l  
Absolut Vodka 0.05l  
Chivas Regal 0.05l  
Beefeater Gin 0.05l  
Jack Daniel's 0.05l  
Jägermeister 0.05l

**5.00€**



Cabernet Sauvignon 187ml  
Chardonnay 187ml

**5.00€**

Peja Helles 0.5l  
Peja Weizer 0.5l  
Peja Pilsner 0.5l  
Heineken 0.33l

**4.00€**



# SkyShop Snacks



Skittles  
m&m's 2.00€



Kinder Chocolate 50g  
Kinder Joy 20g

2.00€



Bake Rolls 80g  
Milka 80g

2.50€



Pringles Chips 40g

3.00€



Eti Crax  
Sedefi Hey  
Stobi Flips

2.00€



Haribo

3.00€



Biskota Sempre



Kids  
Sempre



Vipa Chips  
Classic Mix  
Crunch  
Apple chips

2.50€

2.50€



Oreo 154g  
 Snickers 51g  
 Mars Bar 51g  
 Bounty Bar 51g  
 Twix Bar 51g  
 Kinder Bueno 43g  
 Kit Kat 42g  
 Milkiss Cake Orange  
 Milkiss Cake Milk Cocoa

2.50€

SkyShop  
 Snacks



Musli  
 Pop Kek 45g  
 2.00€



7Days Croissant Double 60g  
 7Days Croissant Cacao 60g  
 2.50€

# SkyShop Meals



200g

Cheese Sandwich

Sanduiq me djath

5.00€

200g  
Dried Beef meat Sandwich  
Sanduiq me përshutë vija

5.00€



Soba Cup Noodles

5.00€



# SkyShop Cigarette



MARLBORO GOLD +

29.00€



Winston BLUE +

24.00€

Camel FILTERS +

25.00€



MARLBORO RED +

29.00€



Terea Amber +

23.00€



# GOGAJ

ÇDO GJË PËR SHTËPINË TUAJ!



ÇDO GJË PËR

SHTËPINË TUAJ!



GOGAJ.INFO

+383 45 155 001

[www.gogaj.com](http://www.gogaj.com)



**SHIJA E ATDHEUT** *në çdo destinacion*

★★★★  
**MIKPRITJE ME ZEMËR, ÇDO DITË!**



# Mirësevini në Hotel Bonita

NË GOLEM, KAVAJË!

**DESTINACIONI IDEAL PËR PUSHIME TË PAHARRUESHME!**

Hoteli me 5 yje ofron pishina të brendshme dhe të jashtme, SPA, qendër fitnesi, plazh privat dhe restorant me kuzhinë cilësore

**+355 69 822 9985 | [www.hotelbonita.al](http://www.hotelbonita.al)**

## Trendi modern i hotelerisë

Mirësevini në Bonita Luxury Resort!

- ✓ Akomodime luksoze
- ✓ Kuzhinë e klasit botëror
- ✓ Relaksohuni dhe rigjallërohuni



**+355 69 559 9916 | [www.hotelbonita.al](http://www.hotelbonita.al)**



**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGIJE



**Transform your  
confidence with  
our expert care!**

We specialize in advanced dentistry and precision hair transplant solutions, combining cutting-edge technology with personalized treatments. From radiant smiles to revitalized hair, we're here to help you look and feel as best as possible.



f @dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,  
Pristina, Kosovo

**Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI**



Part of DENTFIX GROUP



**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC